Gjithashtu ai është një nga sektorët prioritarë edhe të ekonomisë shqiptare, i cili në vitet e fundit po shkon drejt një diversifikimi gjithmonë e më të madh në produktet e ofruara. Referuar të dhënave më të fundit të WTTC “Travel & Tourism Economic Impact 2020, Albania”, ky sektor kontribuon në mënyrë direkte me 8.5% të Produktit të Brendshëm Bruto dhe me rreth 21.2 % në mënyrë indirekte. Në këtë sektor janë të punësuar në mënyrë direkte 7.7% e totalit të punësuarve dhe në mënyrë indirekte 22.2% e tyre. Referuar shpenzimeve nga udhëtarët ndërkombëtarë ato përbëjnë 48.2% të totalit të eksporteve.² Gjithsesi edhe pse zë një peshë të konsiderueshme në ekonomi, numri i turistëve për 1,000 banorë është ndjeshëm më i ulët se vendet e tjera të rajonit të cilat e kanë të mbështetur ekonominë e tyre në sektorin e turizmit. Kroacia llogarit rreth 4,100 turistë për 1,000 banorë, Mali i Zi rreth 3,300, Greqia rreth 2,800 ndërkohë që Shqipëria llogarit rreth 1,900 turistë për 1,000 banorë³. Gjatë viteve të fundit ky sektor ka qenë promotori i rritjes ekonomike të vendit duke arritur rritje vjetore

¹ file:///C:/Users/User/Downloads/Albania2020_.pdf

² <https://wtc.org/Research/Economic-Impact>

³ <https://data.worldbank.org/>

më të lartë se rritja ekonomike që ka patur vendi dhe duke u bërë sektori përcaktues i zhvillimit. Gjatë vitit 2019 ky sektor ka shënuar një rritje me 8.5% ndërkohë që ekonomia e vendit shënoi një rritje me 2.7%.⁴

Referuar edhe prioriteteve strategjike kombëtare dhe sektoriale, turizmi është sektori që ka vëmendjen kryesore strategjike e si i tillë kërkon një promovim dhe diversifikim gjithmonë e më të madh. Në përgjithësi turizmi në Shqipëri është i fokusuar në atë bregdetar dhe më së shumti është turizëm sezonal i përqendruar në tremujorin e tretë të vitit. Gjithsesi vitet e fundit vihet re një tendencë drejt formave të tjera të turizmit, si ai malor, aventuresk, historik, etj. Këto forma të reja të turizmit po bëjnë të mundur një shtrirje më të gjerë kohore të efekteve të këtij sektori në ekonomi dhe në të njëjtën kohë një mbulim më të gjerë gjeografik të vendit.

Procesi i globalizimit e sheh zhvillimin e turizmit jo vetëm si mundësi për të plotësuar nevojat e njeriut, por edhe si mundësi për njohjen e kulturave të tjera, gjë e cila ndihmon për rritjen e mirëkuptimit midis popujve dhe për një të ardhme më të mirë për njerëzimin dhe një zhvillim më gjithëpërfshirës në nivel global.

Pavarësisht trendëve pozitive që ka patur vitet e fundit sektori i turizmit në nivel global, duhet të

⁴ file:///C:/Users/User/Downloads/Albania2020_.pdf

theksohet se ai është dhe një nga sektorët që preken të parët nga fenomene të pa parashikuara siç është situata e krijuar nga Covid 19. Ky sektor është prekur veçanërisht shumë nga pandemia Covid-19, si pasojë e kufizimeve të vendosura për lëvizjen e shtetasve apo edhe kufizimeve të vendosura brenda vendit, duke sjellë rënie në të ardhurat e popullsisë së përfshirë në të si dhe në nivelin kombëtar të të ardhurave.

1.1 Faktorët që ndikojnë në kërkesën për turizëm

Zhvillimi i turizmit kërkon plotësimin e disa kushteve apo standarteve që të ketë efektet e veta në një ekonomi. Kërkesa për turizëm është e lidhur me disa faktor specifik ku mund të përmendim ata gjeografik, demografik, politik, ekonomik, social, etj.

- Faktorët ekonomik janë të larmishëm, ata mund të përfshijnë të ardhurat për frymë, nivelin e investimeve, nivelin e çmimeve, etj.
- Përsa i përket të ardhurave nga teoria ekonomike dimë se një pjesë e buxhetit të familjes shkon për të plotësuar nevojat për ushqim, veshje, strehim. Me rritjen e nivelit të të ardhurave do të rritet dhe mundësia që familja të shpenzojë për turizëm.
- Investimet, sidomos ato në rrugë e komplekse turistike, nga ana tjetër tregojnë mundësitë

që vendi pritës u ofron turistëve të huaj. Në rastin kur jemi të interesuar për mundësitë që ofron vendi pritës për të tërhequr turistë të huaj, niveli i investimeve ka një lidhje më të fortë. Gjithashtu nga modeli ekonomik $Y = C + I + G + Nx$ ekziston një lidhje e drejtë midis investimeve dhe të ardhurave.

Një prej variablave më kryesor në faktoren ekonomik është edhe niveli i çmimeve. Shpenzimet e udhëtarëve mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në varësi të destinacionit të zgjedhur.

Pozicioni gjeografik është një nga faktorët më dominant në zhvillimin e turizmit. Ky faktor lidhet me aksesin që kanë vendet me njëra tjetrën për të zhvilluar sektorin e turizmit. Lehtësirat e lëvizjes mes vendeve ulin ndjeshëm kostot e transportit e si rrjedhim janë më atraktive nga turistët e ndryshëm. Në këtë kuadër zhvillimi i infrastrukturës ndërkufitare, asaj ajrore dhe detare janë prioritare për të zhvilluar sektorin e turizmit.

Ndër faktorët social me influencë në turizëm mund të përmendim cilësinë e shërbimeve turistike, nivelin e arsimit, monumentet historike. Edhe pse shpesh këta faktor janë shumë të rëndësishme, është pothuajse e pamundur për të përcaktuar nivelin sasior të tyre. Shpesh janë këta faktor që bëhen

objekt i tërheqjes së turistëve në një vend të caktuar krahasuar me një tjetër.

Faktorët politik shpesh bëhen thelbësorë në vendet me regjime autoritare dhe me ekonomi të kontrolluara që pritet të shfaqin jo stabilitet shoqëror dhe për këtë arsye, të jenë më pak tërheqëse si destinacione turistike. Vendet me problemet politike dhe keq-menaxhim ekonomik kanë më pak të ngjarë të ketë të zhvilluar infrastrukturën turistike, pra si pasojë më pak kërkesë. Vendet e karakterizuara nga kushte të paqëndrueshme politike kanë më shumë gjasa të jenë objekt i sulmeve terroriste, të cilat pengojnë kërkesa, siç është treguar në studime të shumta të mëparshme. Efekti i një konflikti të dëmshëm politik mbi turizmin duhet të merren në konsideratë për shkak se ajo mund të dëmtojë turizmin dhe për të zvogëluar kërkesën.

2. Turizmi në Shqipëri

Karakteristikat kryesore të turizmit në Shqipëri formohen nga pozita gjeografike e saj shumë pranë vende të zhvilluara të BE të cilat karakterizohen nga nivel i lart të të ardhurave për frymë dhe nga ana tjetër të vendit tonë i cili është një nga vendet me të ardhurat për frymë më të ulëta në Evropë. Në këtë aspekt shpenzimet për turizëm në Shqipëri janë shumë më

të ulëta sesa vendet fqinje të cilat janë anëtare të BE. Gjithashtu shtrirja gjeografike përgjatë detit Adriatik dhe Jon e bën vendin tonë atraktiv edhe për shtetet e tjera të rajonit pa dalje në det siç janë Maqedonia, Kosova, Bosnja dhe Serbia. Për rrjedhojë turizmi më i përhapur është ai bregdetar e si rezultat, janë zhvilluar qytete bregdetare të vendosura në ultësirën perëndimore ku turizmi sjellë një pjesë të madhe të të ardhurave. Ajo që vihet re është fakti se aktiviteti turistik në pjesën bregdetare kulmon gjatë sezonit të verës duke tërhequr përveç turistëve vendas, edhe shumë turistë të huaj, por ende nuk ka marrë një diversifikim kohor përgjatë gjithë vitit. Gjithësi vitet e fundit vihet re zhvillimi edhe i formave të tjera të turizmit siç është ai kulturor, natyror, etj.


Turizmi kulturor bazohet në trashëgiminë historike dhe kulturore ku përfshihen parqe arkeologjike të vendit si parku i Butrintit, Apolonisë, Bylisit, etj dhe zona të mbrojtura nga UNESCO si Berati dhe Gjirokastra, të cilat janë pjesë e trashëgimisë botërore, por njëkohësisht edhe kështjellat, muzetë, etj.

Turizmi natyror ka qënë më tepër në fokus të turistëve të huaj, por kohët e fundit gjithnjë e më shumë ka tërhequr vëmendjen e turistëve vendas. Vitet e fundit ky lloj turizmi ka përparuar duke ofruar një

larmi aktiviteteve si ngjitje në mal, rafting në lumenj të ndryshëm, shëtitje me kuaj, etj duke shoqëruar me ushqimet tradicionale të zonave të ndryshme të vendit. Diversifikimi i produkteve turistike dhe në të njëjtën kohë ekzistenca e një diapazoni më të gjerë të pranisë së turistëve ka bërë që numri i tyre të rritet në mënyrë të konsiderueshme nga viti në vit.

Në vitin 2019 numri i turistëve të huaj arriti në 6.4 milion me një rritje prej 8.1% krahasuar me vitin e mëparshëm dhe nga të cilët rreth 90.8% ishin për qëllim pushimesh në vend. Ky trend u ndalua nga kriza globale e krijuar nga Covid 19, krizë e cila bëri që në vitin 2020 numri i turistëve të huaj binte me 58.5% ose të kishte një total prej 2.66 milion turistë nga 6.4 që ishin në 2019. Kjo rënie drastike në numrin e turistëve pati padyshim rënie në nivelin e të ardhurave në vend nga turizmi, e për rrjedhojë ndikoi negativisht në rritjen ekonomike të vendit në vitin 2020.


Grafik 1: Numri i shtetasve të huaj sipas qëllimit



Burimi: INSTAT, http://databaza.instat.gov.al/pxweb/en/DST/START__TU/TU3/?rxid=a01d21dc-f261-42d9-b01a-986027e11fc2

Periudha Mars -Dhjetor 2020 ka ndikuar më shumë në rënien e numrit të turistëve për shkak se korrespondon me mbylljen masive që u bë në vendin tonë dhe vendet e tjera. Kjo bëri që për këtë periudhë rënia të ishte me 63.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafik 2: Numri i shtetasve të huaj sipas qëllimit për periudhën Mars -Dhjetor




Burimi: INSTAT, http://databaza.instat.gov.al/pxëeb/en/DST/START__TU/TU3/?rxid=a01d21dc-f261-42d9-b01a-986027e11fc2

Kriza e krijuar nga Covid 19 padyshim që pati një impakt të madh edhe në ekonomi. Shpenzimet e bëra në vitin 2019 arritën në vlerën e 2,458 milion dollarëve me një rritje me 6.6% krahasuar me vitin e kaluar ose në 384 dollar për turist. Ndërkohë që në vitin 2020 llogaritet që shpenzimet të jenë në nivelin e 1,034 milion dollarë ose rreth 58% më pak krahasuar me vitin 2019.

SA DHE SI NXIRRET NË PAH TRASHËGIMIA KULTURORE NËPËRMJET KOMUNIKIMIT?

Grafik 3: Shpenzimet e turistëve të huaj në Shqipëri (në milion dollar)




Burimi: UNWTO, Albania: Country-specific: Basic indicators (Compendium) 2015 - 2019 (07.2020); <https://www.e-unwto.org/doi/suppl/10.5555/unwtotfb0008010020152019202007>

Shënim: për vitin 2020 nuk ka të dhëna mbi shpenzimet e bëra nga turistët e huaj në vend. Për të bërë të mundur këtë vlerësim është bërë ponderim me mesatare rrëshqitëse me katër terma mbi shpenzimet për turist.

Të dhënat tregojnë se vendet kryesore nga të cilat vijnë turistët ndërkombëtarë janë vendet fqinje si Kosova, Mali i Zi dhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Turizmi gjatë sezonit veror mbështetet edhe nga nivelin i emigrimit, duke qenë se një numër i madh emigrantësh shqiptarë kthehen në vend, kryesisht në verë për pushime.

Grafik 4: Struktura e turistëve të huaj në Shqipëri sipas vendit të origjinës 2019



Burimi: INSTAT, [http://www.instat.gov.al/media/7945/1% C3% ABvizjet-e-shtetasve-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-dhjetor-2020.pdf](http://www.instat.gov.al/media/7945/1%20C3%20ABvizjet-e-shtetasve-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-dhjetor-2020.pdf)

Por nuk duhet lënë jashtë vëmendjes turizmi brenda vendit, i cili vitet e fundit ka marrë edhe me tepër zhvillim. Udhëtimet jashtë vendit kërkojnë shuma më të larta për të shpenzuar, ndërsa udhëtimet brenda vendit janë më pak të kushtueshme, e për rrjedhojë më të arritshme për një numër më të madh njerëzish. Në këtë kontekst, vihet re zhvillimi i turizmit në zonat veriore dhe lindore të vendit, kryesisht turizëm natyror/rural, nëpërmjet udhëtimeve 1-2 ditore, krahasuar me përqendrimin e mëparshëm në zonat perëndimore bregdetare. Përveçse i ka dhënë shtysë zhvillimit të këtyre rajoneve, turizmi është shpërndarë edhe në periudha të ndryshme të vitit,

përkundrejt lëvizjeve drejt bregdetit kryesisht gjatë muajve të verës.

Ndikimi në ekonomi - Ndikimi i turizmit në ekonomi vihet re në të ardhurat e përftuara nga shpenzimet e turistëve në vend, por edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në investimet për strukturat akomoduese dhe në punësim në ato aktivitete që i shërbejnë zhvillimit të turizmit.

Sipas të dhënave të raportuara nga INSTAT, në publikimin “Turizmi në Shifra” mbi vitet 2013-2017, shpenzimet e turistëve në vendin tonë llogariten mesatarisht 13,3% të PBB. Ndërsa pesha e shpenzimeve të turistëve të huaj, si eksport, zë 14.9 % të totalit të eksportit. Aktivitetet që lidhen direkt me turizmin si akomodim, shërbime ushqimi dhe pije, agjenci udhëtimi, operator turistik, qera e makinave dhe të tjera aktivitete të shërbimit të rezervimit në vitin 2017 kanë gjeneruar 39 miliardë lekë, bazuar në të dhënat e publikuara nga INSTAT.

Turizmi në Shqipëri ka qënë përqendruar kryesisht në ultësirën perëndimore dhe më tepër në jug të saj. Por zhvillimi i infrastrukturës rrugore vitet e fundit, i ka dhënë hapësirë turizmit në zonave të tjera të vendit si verilindja dhe juglindja. Statistikat e turizmit tregojnë se dy destinacionet më të kërkuara në rezevimin e akomodimit janë Vlora me 38.8%

dhe Korça me 20.1 %. Zhvillimi i turizmit në zona të tjera, jo bregdetare, krijon hapësira për aktivitetet e bizneseve gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm gjatë sezonit të verës.

Punësimi në turizëm - Turizmi ka një ndikim jo vetëm ekonomik por edhe social duke qenë se punëson një numër të madh individësh, duke mbështetur zhvillimin e qendrueshëm dhe luftuar varfërinë. Lëvizjet demografike dhe zhvillimi i teknologjisë ka rritur konkurrencën dhe e ka bërë gjithnjë e më të vështirë punësimin e të rinjve (grupmosha 15-24). Si një sektor ende në zhvillim e sipër, turizmi po krijon gjithnjë e më tepër mundësi punësimi për individët pavarësisht kualifikimit të tyre. Karakteristikat e veçanta të këtij sektori krijojnë mundësi për punësimin e personave me nivel arsimit bazë ose të mesëm. Integrimi të rinjve në aktivitetet turistike ju jep atyre jo vetëm një punë dhe të ardhura momentale, por edhe një mundësi për të ardhmen. Duke investuar në trajnimin dhe kualifikimin e tyre, do të mund të ofrohet një shërbim më cilësor për klientët, gjë që do të sjellë më shumë turistë dhe rrjedhimisht, më shumë të ardhura. Në këtë mënyrë, krijohen hapësira për zhvillim në karrierë dhe punësimin në nivele më të larta.

Investimet - Në ditët e sotme ku mënyra e jetesës është në ndryshim të vazhdueshëm, si rrjedhojë e levizjeve demografike, ndryshimeve të mëdha në teknologji por dhe në fusha të tjera, biznesi duhet të përshtatet për të ndjekur kërkesat dhe preferencat e konsumatorit.


Për të tërhequr sa me tepër turistë, bizneset që operojnë në këtë fushë duhet të investojnë. Investimet e lidhura me turizmin janë kryesisht në struktura akomoduese, ku sipas INSTAT, 75 leje ndërtimi për ndërtim hotelesh janë aprovuar në vitin 2018 dhe 67 të tjera në vitin 2019.

3. Impakti i pandemisë

Turizmi është prekur në një masë të madhe nga pandemia Covid-19 si pasojë e kufizimeve të vendosura për lëvizjen e individëve. Kufizimet në lëvizje kanë sjellë rënie në numrin e turistëve që kanë vizituar Shqipërinë gjatë kësaj periudhe dhe një rritje të lehtë të turizmit vendas si rezultat i pamundësisë së shqiptarëve për të shkuar me pushime jashtë vendit. Sipas informacionit të INSTAT, 48% e shtetasve të huaj vijnë në tremujorin e tretë të vitit. Ndërkohë, numri i vizitorëve në tremujorin e tretë të vitit 2020 është ulur me 43,3 %, në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të mëparshëm. Duke ndjekur të njëjtin trend me numrin

e vizitorëve edhe numri i netë qëndrimeve gjithsej është ulur me 44,9 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2019.

Grafik 5: Vizitorë rezident dhe jo-rezident sipas rajonit



Nga ana tjetër, siç tregon edhe grafiku i mësipërm, është rritur numri i turistëve vendas në rajonin jugor, që mund të shpjegohet si numri i turistëve shqiptarë që në situatë normale, do të preferonin t'i kalonin pushimet jashtë vendit, por nga kufizimet e vendosura si pasojë e pandemisë, i janë drejtuar jugut të Shqipërisë.

BIBLIOGRAFI

- Michael Brakke, "International Tourism, Demand, and GDP Implications: A Background and Empirical Analysis", *St. John's University*.
- Mohd Hafiz Mohd Hanafiah and Mohd Fauzi Mohd Harun, "Tourism Demand in Malaysia: A cross-sectional pool time-series analysis", *International Journal of Trade, Economics and Finance*, Vol. 1, No. 1, June, 2010 2010-023X
- Nikolaos Dritsakis and Spiros Athanasiadis, "An Econometric Model of Tourist Demand": The Case of Greece (2004)
- White, K. An International Travel Demand Model: US Travel to Western Europe. *Annals of Tourism Research*, 12 (1985), 529-545.
- Divisekera, S. (2003). "A model of demand for international tourism." *Annals of Tourism Research* 30(1): 31-49.
- Jeremy J. Foster, 1998, 2001, "Data Analysis Using SPSS for Windows Versions 8 to 10 A Beginner's Guide".
- Juan Luis Eugenio-Martín, "Tourism and economic growth in Latin American countries: A Panel data approach".
- Smeral, E. and A. Weber (2000). "Forecasting international tourism trends to 2010." *Annals of Tourism Research* 27(4): 982-1006.
- Kulendran, N. and M.L. King (1997). "Forecasting international quarterly tourist flows using error-correction and time-series models." *International Journal of Forecasting* 13(3): 319-27.

- <https://wttc.org/Portals/0/Documents/Reports/2018/Domestic%20Tourism-Importance%20Economic%20Impact-Dec%2018.pdf?ver=2021-02-25-182514-683>
- <https://wttc.org/Portals/0/Documents/Reports/2019/World%20Transformed-Megatrends%20and%20their%20Implications%20for%20Travel%20and%20Tourism-Jan%202019.pdf?ver=2021-02-25-182733-437>
- <https://wttc.org/Portals/0/Documents/Reports/2021/Travel%20and%20Tourism%20as%20a%20Catalyst%20for%20Social%20Impact.pdf?ver=2021-02-25-183248-583>
- <https://wttc.org/Portals/0/Documents/Reports/2019/Social%20Impact-Generating%20Jobs%20for%20Youth-Jan%202019.pdf?ver=2021-02-25-182754-083>
- <https://wttc.org/Portals/0/Documents/Reports/2017/Coping%20With%20Success%20-%20Managing%20Overcrowding%20in%20Tourism%20Destinations%202017.pdf?ver=2021-02-26-192645-677>
- <http://instat.gov.al/media/4169/turizmi-ne-shifra-2018.pdf>
- <http://www.instat.gov.al/media/7992/turizmi-ne-shifra-2019.pdf>
- <http://www.instat.gov.al/media/7749/strukturat-akomoduese-t3-2020.pdf>
- <http://www.instat.gov.al/media/7331/anketa-e-turizmit-strukturat-akomoduese-2019.pdf>
- https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/al/Documents/financial-services/Vizioni%20juaj%20-%20Parashikimi%20per%202021_Shqip.pdf

Prof. As. Dr. Sofia DELIJORGJI

MSc. AIDA ZOTO

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

TRASHËGIMIA KULTURORE E KRAHINËS SË DROPULLIT

Abstract

The province of Dropull represents an ethno-cultural area that inherits a rich and diverse spiritual cultural wealth. The area has preserved and transmitted «phylloxene»(hospitality), Greek language, literature and civilization, beautiful dances, polyphony, richcostumes, Epirote clarinet motifs, churches and monasteries, archeological sites, characteristic architecture, stone works, handicrafts, crafts, processing of agricultural and livestock products, gastronomy related to tradition, rich and delicious menu, while essential oil sand medicinal plants represent another natural wealth of this area. Dropulli's residents are characterized by a high interest in education, culture and social progress ingeneral.

This paper will present all these elements, ethnographic and cultural features of the past and inherited from generation to generation.

Keywords: *Dropull, civilization, culture.*

Bashkia Dropull

Bashkia e Dropullit ndodhet në Qarkun e Gjirokastrës dhe shtrihet në pjesën juglindore të vendit tonë. Kjo bashki përbëhet nga 3 njësi administrative, të cilat janë: Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm dhe Pogoni. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Gjirokastrë dhe e qarkut Gjirokastrë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj 41 fshatra; njësitë Dropull i Poshtëm - fshatrat: Dervican, Goranxi, Vanistër, Haskovë, Dhuvjan, Sofratikë, Terihat, Goricë, Frashtan, Lugar, Grapsh, Peshkëpi e Sipërme, Peshkëpi e Poshtme, Glinë, Vrahogoranxi, Radat me një total 9.246 banorë; Dropull i Sipërm - fshatrat: Jorgucat, Zervat, Bularat, Bodrishtë, Kërrë, Vodhinë, Pepel, Klishtar, Selo, Likomil, Llovinë, Krioner, Sotirë, Llongo, Koshovicë, Dritë, Kakavie, Vrisera me një total 9,559 banorë; Pogoni - fshatrat: Poliçan, Skore, Sopik, Çatistër, Mavrojer, Hllomo, Selckë me një total 3,473 banorë.

Këto fshatra të banuara ndodhen kryesisht në të djathtë të rrugës nacionale që të çon drejt jugut në Kakavijë, pika kufitare me Greqinë.

Qendër bashkie, është fshati Jorgucat. Ai gjendet në pozicion gjeografik të përshtatshëm duke qenë në qendër të Dropullit, në degëzimin e rrugës nacionale Gjirokastrë – Kakavi dhe Gjirokastrë – Sarandë¹.

Bashkia e Dropullit përbëhet nga pjesëtarë të pakicës etnike greke në Shqipëri dhe kjo e bën atë kryesisht popullsi homogjene. Kjo zonë është karakterizuar përherë nga emigracioni, theksuar kjo dukuri pas vitit 1997, ku popullsia karakterizohet nga mosha e tretë dhe të rinj përgjithësisht të larguar në emigracion.

Bazuar në të dhënat e Censusit 2001 dhe 2011, popullsia e Dropullit, gjatë periudhës 10 vjeçare 2001-2011, është reduktuar në masën 79%².

Dropulli në kohë dhe në hapësirë

Për Dropullin njihen dy emra, një si titull metropol *Dhrinopoleos* dhe një si emër krahinë *Dheropoli*. Emri i parë është i përdorshëm dhe i njohur në rrethe kishtare, ndërsa i dyti është i njohur në rrethet më të gjera laike.

Të dy emrat nga ana semasiologjike kanë të njëjtin kuptim *qytet melisa*. Ndryshimi midis tyre qëndron vetëm nga ana e formës fonetike. Emri i parë është në

¹Bashkia Dropull – Pasaporta <https://portavendore.al/bashkia-dropull/pasaporta-e-bashkise-dro-pull/>

²The United Nations Development Programme - Plani Operacional i Zhvillimit Vendor – Bashkia Dropull <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home.html#f10-16>

gjuhën greke, ndërsa i dyti është në gjuhën popullore, i cili është mbartës autentik i identitetit kombëtar. Këto forma fonetike i gjejmë kryesisht ndër brezat e vjetër dhe në disa këngë popullore si: *Në fushën e Dropullit, Moj Dropullite* etj. Pra, bëhet fjalë për dy emërtime sinonime të së njëjtës fjalë. Duke u nisur nga forma fonetike popullore dhe duke pasur parasysh zhvillimin fonetik që ka pësuar ky emërtim konstatojmë se është një fjalë e përberë ku fillimisht është formuar tema e parë e gjuhës se lashtë greke, e dialektit dorik, *dhendhro* që do të thotë *lis* dhe tema e dytë po nga gjuha e lashtë greke *polis* që do të thotë qytet. Por, fjalët nuk mbeten të pa ndryshuara dhe gjatë kohës ndryshojnë formë për të lehtësuar shqiptimin e tyre, sipas ligjeve të brendshme që veprojnë në një gjuhë³.

Pasuria e trashëgimisë kulturore, historike dhe fetare

Monumentet e trashëgimisë kulturore, historike dhe fetare të zonës së Dropullit janë simbole të rëndësishme që tregojnë vlerat materiale, shpirtërore dhe zhvillimin në shekuj dhe vite. Zona ofron burime dhe atraksione natyrore që favorizojnë si turizmin familjar, ashtu edhe aktivitete të ndryshme turistike në natyrë.

³ Dropulli në kohë dhe në hapësirë <https://www.bashkiadropull.gov.al/dropulli-ne-kohe-dhe-ne-hapesisre/>

SA DHE SI NXIRRET NË PAH TRASHËGIMIA KULTURORE
NËPËRMJET KOMUNIKIMIT?

Sipas Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, në rrethin e Gjirokastrës kemi rreth 545 monumente të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje nga të cilat rreth 40 i takojnë Bashkisë së Dropullit⁴. Më poshtë paraqitet një tabelë e përmbledhur:

EMËRTIMI I MONUMENTIT	FSHATI	BASHKIA
KALAJA SELOS	Selo	Dropull i Sipërm
KALAJA E PEPELIT	Pepel	Dropull i Sipërm
RRËNOJAT E TEATRIT ANTIK	Sofratikë	Dropull i Poshtëm
VARRI MONUMENTAL DHE UJËMBJELLËSI NË JORGUCAT	Jorgucat	Dropull i Sipërm
VARREZA ANTIKE NË V.L.TË FSHATIT SOFRATIKË	Sofratikë	Dropull i Poshtëm
URA NË FSHATIN HASKOVË	Haskovë	Dropull i Poshtëm
URA NË FSHATIN GRAPSH	Grapsh	Dropull i Poshtëm
URA E MADHE E GURIT E KAÇARRELOS MBI LUMIN KAÇARREL		Dropull
URA E GURIT E ÇIMINXHIT MBI LUMIN E SOPIKUT	Pogon	Pogon
PUSI KARAKTERISTIK PRAPA GJELLTORES SË FSHATIT SOFRATIKË	Sofratikë	Dropull i Poshtëm
STERA E UJIT		Dropull

⁴ Lista e Monumenteve të Kulturës - Qarku Gjirokastrë
http://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2020/10/Monumentet_-Qarku-Gjirokastrë.pdf

TRASHËGIMIA KULTURORE E KRAHINËS SË DROPULLIT

ÇEZMA NË GUVËN SHKËMBORE PRANË MANASTIRIT TË SHËN MËRISË	Goranxi	Dropull i Poshtëm
ÇEZMA ME KUPOLË	Selckë	Pogon
ÇEZMA E HLLOMOS	Hollmo -pogon	Pogon
MANASTIRI I SHËN QIRJAKUT DHE JULITËS	Dhuvjan	Dropull i Poshtëm
MANASTIRII I SHËN MËRISË	Goranxi	Dropull i Poshtëm
MANASTIRI I UNGJËLLIZIMIT	Vanishtë	Dropull i Poshtëm
KISHA E MANASTIRIT TË SHPËRFYTYRIMIT	Çatistë	Pogon
KISHA E MANASTIRIT TË SHËN TRIADHËS	Pepel	Dropull i Sipërm
KISHA E MANASTIRIT TË PROFET ILISË	Jorgucat	Dropull i Sipërm
KISHA E MANASTIRIT TË SHËN MËRISË	Koshovice	Dropull i Sipërm
KISHA E SHËN MËRISË SË DRIANOS MBI FSHATIN ZERVAT	Zervat	Dropull i Sipërm
KISHA E SHËN MËRISË	Sopik	Pogon
KISHA E SHËN MËRISË	Zervat	Dropull i Sipërm
KISHA E SHËN MËRISË	Peshkepi e Sipërme	Dropull i Poshtëm
KISHA E SHËN MËRISË	Vllahogoranxi	Dropull i Poshtëm
KISHA E SHËN MËRISË	Derviçan	Dropull i Poshtëm
KISHA E SHËN KOLLIT	Dhuvjan	Dropull i Poshtëm
IKONOSTASI I KISHËS SË SHEN THANASIT	Selo	Dropull i Sipërm

SA DHE SI NXIRRET NË PAH TRASHËGIMIA KULTURORE
NËPËRMJET KOMUNIKIMIT?

KISHA E SHËN E PREMTES	Hllomo	Pogon
KISHA E SHËN E PREMTES	Selckë	Pogon
KISHA E MEZHARIT	Polican	Pogon
RRËNOJAT E BAZILIKËS PALEOKRISTIANE PRANË FSHATIT GORICË	Goricë	Dropull i Poshtëm
RRËNOJAT E KISHËS SË SHËN ANËS (PANAJOTOPULLA)	Derviçan	Dropull i Poshtëm
BANESA E ZAHARI STERIES	Derviçan	Dropull i Poshtëm
BANESA E VASIL DRAZHES	Hllomo	Pogon
KULLA E VANGO DULES	Derviçan	Dropull i Poshtëm
KULLA E MIHO NGJELËS	Goranxi	Dropull i Poshtëm

Veshjet tradicionale dropullite

Veshjet e përdorura e zonës së Dropullit janë të larmishme dhe elegante, të zbukuruar shumë herë me shije të hollë. Ato flasin jo vetëm për një nivel ekonomik mjaft të ngritur, por edhe për shije estetike mjaft të zhvilluara. Dëshmi për këtë janë veshjet e grave të Dropullit, në të cilat, ka një harmoni të përkryer midis pjesëve të veçanta që përbëjnë kostumin. Karakteristikë e përbashkët e veshjeve të grave është përdorimi i cohës ngjyrë blu të errët, nganjëherë me nuanca drejt të zezës. Parapëlqimi i ngjyrave të errëta duket se ka pasur lidhje me kushtet shoqërore të së kaluarës, kur mërgimi ekonomik i burrave mori

përpjesëtime të mëdha. Në Dropull përdorim më të gjerë kishte liri, por krahas tij përdorej edhe leshi. Për më tepër, në këto zona, të banuara nga pakicat greke, përkatësia e ndryshme etnike e popullsisë shfaqej edhe në kostumet e tyre popullore.

Veshja e grave të Dropullit

Kur shqyrton veshjet e grave të kësaj zone, ajo që të tërheq vëmendjen është harmonia e të gjitha pjesëve kryesore që përbëjnë kostumin. Asaj i japin individualitet të veçantë dy shkallëzime që krijohen (njëri në pjesën e poshtme dhe tjetri në pjesën e sipërme të saj) si pasojë e të veshurit njëra mbi tjetrën të pjesëve që e përbëjnë. Në të poshtmen vijnë me radhë: këmisha e pastaj *fusta* (fundit), pjesët fundore të të cilave janë të zbukuruara me kllapodan; e treta, fermeleja e, mbi të, coha. Shkallëzimi tjetër, ai i pjesës së sipërme, krijohet tek kyçi i dorës. Së pari, shihet mënga e gjerë e këmishës e punuar me dantellë, pastaj mënga e dollomasë që është prerë në formën e një trapezi; së fundi, mënga e gjerë shumë e zbukuruar, emantos prej cohe ose kadifeje. Kostumet lokale janë tradicionalisht të zbukuruar me qëndisma të komplikuar, dantella dhe punime me grep e qëndisma⁵. Veshja e grave të Dropullit

⁵ Akademia e Artit dhe Trashëgimisë ODEA <http://odeacademy.org/veshje-grash>

të Poshtëm ishte shumë e afërt me atë të Dropullit të Sipërm. Kështu, shajaku (apo shita), këmisha, mbulesa e kokës dhe mënyra e lidhjes së saj dallonin vetëm në elemente të dorës së dytë, ndërsa veshja e Rrëzës së Buretos ishte e njëjtë me veshjen e përdorur në Dropullin e Poshtëm⁶.



*Burimi: Η φορεσιά της Δρόπολης - κείμενα και φωτογραφίες
(Kostumi i Dropullit - tekste dhe fotografi)
<http://filipjovanis.blogspot.com/2013/11/blog-post.html>*

*Veshja e nuses së Dropullit - Kostumi i nuses dropullite
është ndër kostumet më të bukura në fondin e etnografisë*

⁶ Akademia e Artit dhe Trashëgimisë ODEA <http://odeacademy.org/veshje-grash>

shqiptare dhe diversitetit kulturor tradicional. Kjo veshje tradicionale e zonës vazhdon edhe sot të përgatitet në të gjitha proceset e saj prej prerjes, vizatimit dhe qëndisjes në mënyrë krejtësisht artizanale⁷. Kostumi përbëhet nga një *kavadhi* (këmishë) i qëndisur me fije ari dhe argjendi. Mëngët e gjata përfundonin në formën e një pëllëmbë të hapur dhe të rrumbullakët⁸.



Burimi: Η φορεσιά της Δρόπολης - κείμενα και φωτογραφίες (Kostumi i Dropullit - tekste dhe fotografi)

<http://filipjovanis.blogspot.com/2013/11/blog-post.html>

⁷ Ministria e Kulturës. Shoqata Kulturore Artistike “Dropulli”: “Zonja e kostumeve” (Minoriteti grek në Shqipëri) <https://kultura.gov.al/en/shoqata-kulturore-artistike-dropulli-zonja-e-kostumeve-minoriteti-grek-ne-shqiperi/>

⁸ Akademia e Artit dhe Trashëgimisë ODEA <http://odeacademy.org/veshje-grash>

Veshja e burrave të Dropullit - veshja më përfaqësuese për burra ka qenë kostumi me fustanellë. Kostumet tradicionale të burrave përfshijnë poture të bardha leshi, të gjëra në bel që përfundojnë të ngushta tek këmbët dhe shoqërohen me dollakët e pulpat ose fustanellat e bardha me pala, të shoqëruara me jelek dhe opinga me xhufka. Në kokë mbahej një kapllak i gjatë e i zi, prodhuar me lesh qengji ose një qeleshe prej shajaku me majë. Tipar i përbashkët ishte fustanella, jeleku, opingat, kësula. Ngjyra e mëngores ishte blu e thellë drejt së zezës. Një tjetër element, qylafi (kapelja), ka ndryshuar dy herë formë; deri në vitet e Pavarësisë Kombëtare përdorej një feste e kuqe, me një xhufkë disi të gjatë që varej deri përmbi supe, ndërsa më pas filloi të përdorej gjithnjë e më shumë një kësulë prej belluzi ose kadifeje të zezë. Veshja plotësohej me brezin e gjerë mbi të cilin ngjishej silahu, ku burri mbante armët e brezit. Si veshje e rëndë dimri për burra mbahej bërruci izi⁹.

⁹ Akademia e Artit dhe Trashëgimisë ODEA <http://odeacademy.org/veshje-burrash>



Burimi: Η φορεσιά της Δρόπολης - κείμενα και φωτογραφίες (Kostumi i Dropullit - tekste dhe fotografi) <http://filipjovanis.blogspot.com/2013/11/blog-post.html>

Vallja dropullite (dropullitçe)

Vallja e vajzave dropullite, e emërtuar nga fakti se kjo valle e ka burimin dhe origjinën nga zona etno-kulturore e Dropullit, është një folklor instrumental dhe koreografik. Tipologji e trashëgimisë shpirtërore të minoritetit etnik grek, pjesë e diversitetit kulturor në Shqipëri, që nga viti 2010 është pjese e listës kombëtare të kryeveprave të trashëgimisë kulturore shpirtërore. Është një valle e shtruar me hapa të shkurtër e kursyer në lëvizje që vë në pah hijeshinë dhe pasurinë e kostumeve të zbukuruara me qëndisma ari, monedha të florinjta mbi ballë në gjoks.

Vallja dropullitçe njihet edhe si koreografi, por edhe si melodi (vallet e kënduara dhe valle me saze). Vallet e marrin emrin nga kënga që i shoqëron, p.sh. *Pogobishte, Gajtanaqi, Kostandas, Vllaha, Kleftes, Aleksandra; Karaguna, OsmanTaga* (vallja e burrave), *Karakaksa* (vallja e vajzave) etj.¹⁰



Burimi: Ansambli Dropulli, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, maj 2019

Tradita muzikore- iso polifonike dropullite

Në zonën e Dropullit kemi traditën e këndimit të shumëzërëshit muzikor tradicional por edhe atë me saze, në shqipe dhe në greqisht, duke shkëmbyer modelet e këndimit shumëzërësh, qoftë muzi kalisht apo edhe së bashku me tekstin përkatës, nga njëra gjuhë në tjetrën dhe nga njeri repertor në tjetrin

¹⁰ Kulturë shpirtërore nga Dropulli <http://www.arkivalajmeve.com/Kulture-shpirtërore-nga-Dropulli.1046947261/>

E interpretuar më së shumti nga burrat, muzika shoqërohet nga një varg i gjatë ngjarjesh shoqërore e familjare si dasmat, funeralet, festat e korrjes, festimet fetare etj. E integruar në Iso-polifoninë shqiptare, ajo është njohur që nga viti 2005 nga UNESCO si trashëgimi kulturore e paprekshme.

Sazet (gërnetë, violinë, lahutë, fizarmonikë, dajre), janë të lidhura me gjuhën muzikore të kësaj zone dhe kanë një nga rolet më të rëndësishme në ruajtjen, përcjelljen dhe zhvillimin e traditës muzikore¹¹. Nga grupet e shquara iso polifonike përmendim grupet e burrave të Poliçanit, Goranxisë, Ajnikollës, Koshovicës, atë të grave të fshatit Sotirë, si dhe këngëtarët *Uaqi Haxhi*, *Pilo Hashoti*, *Raqi Rexho*, *Jorgo Shendi*, *Persefoni Simo*, *Efterpi Gaco*, *Ollga Malo*, *Elpiniqi Goga*, *Polikseni Iso* etj. Tradita e sazeve në zonën e Dropullit, konkretizohet nga sazet e familjes *Mastora* ose të familjes *Gjiza*, të cilat me artin e tyre renditen ndër sazet më të mira në Shqipëri¹².

Kulinaria dhe tradita

Zona e Dropullit shquhet për traditë të pasur dhe karakterizohet nga një menu e pasur, plot aroma dhe

¹¹ Akademia e Artit dhe Trashëgimisë ODEA <http://odeacademy.org/minoriteti-grek>

¹² Arkivi i Isopolifonisë Shqiptare. Sazet e Dropullit ndërvite, Gjirokastër <http://isopoli1.w03.wh-2.com/ShowSaze.aspx?id=42>

shije. Në thelb është kuzhinë «malore» dhe mbështetet kryesisht në produktet blegtorale: qumësht, kos, djathë, mish dhe deleje. Kuzhina lokale dhe prodhimet e certifikuara lokale të ndërthurura me etnografinë e pasur të komuniteteve lokale ofrojnë traditë, shije e mikpritje të mrekullueshme. Disa nga gatimet të prejardhura nga përbërësit bazë janë:

Qumështi: përdoret për përgatitjen e gjalpiti, kosit, gizës, shëllirës dhe natyrisht djathërave të saj (djathë i bardhë fuçie) etj.; *Buka*: bukë me tharmë, mamaca ose bobota (bukë misri) ose bobota, kathario ose tsoureki (bukë gruri), vrizino (bukë thekre), bukë me kungull etj.; *Mishi*: pastërma (mish i kripësuar dhe i tharë në tym), kavurmas (mish i pastruar nga kockat dhe i vendosur në shtambë balte), kokinisto (çomlek), mish me patate në ngastër ose tavë, briam (mish me turli), paçe, kukurec etj.; *Brumëra*: kurkuti (brumë i hollë i bërë me ujë, miell dhe maja për gatimin e petullave), bugaçe e ëmbël, trahana (e ëmbël dhe e thartë) etj. *Byrekë*: me mish, me pulë, me kungull, me lakra, me djathë, me qumësht, me presh, me makarona, me oriz etj.; *Ëmbëlsira*: gliko (qersh, fik, kumbull, ftua, pjeshkë etj.), me sherbet (bakllava, revani, kadaif, me arra etj.); *Pije*: tsipuro (raki), verë, çaj mali, liker etj.¹³

Dropulli paraqet vlera të përtëritura kulturore, arsimore dhe shëndetësore, një zhvillim ekonomik

¹³ Γιώτης Α. 2003. Εδεσματολόγιον Ηπείρου. Ελληνικά γράμματα.

të qëndrueshëm, një industri bashkëkohore të përpunimit të prodhimeve bujqësore, një mjedis të pastër ku ruhet harmonia e bashkëjetesës evropiane. Bukuria e kësaj zone është një perlë e fshehur gati për t'u eksploruar e për të mirëpritur gjithë të interesuarit.

BIBLIOGRAFIA

Arkivi i Isopolifonisë Shqiptare. Sazet e Dropullit ndër vite, Gjirokastrë <http://isopoli1.w03.wh-2.com/ShowSaze.aspx?id=42>

Arkivi i Isopolifonisë Shqiptare. Sazet e familjes Mastora, Dropull <http://isopoli1.w03.wh-2.com/ShowSaze.aspx?id=8>

Bashkia Dropull, Projekti Bashki të Forta&Smart Processes, 2019, Bashkia Dropull – Raporti i Performancës 2019 <http://bashkiteforta.al/wp-content/uploads/2021/02/Raporti-Performanc%C3%ABs-Dropull-FINAL.pdf>

Çuko, P. 1964. Këngëve popullore. Rrev. Ylli, nr. 11, 12. <https://www.himara.gr/ist4-syntomi-gnorimia-istoria-deropolis>

<https://www.searchculture.gr/aggregator/edm/kemnepp/000126-76605>

Kasoruh. N. 2003. Mes këngëve dhe valleve të Dropullit. Toena.

- Kasoruho. N. 2000. Gjirokastra e festivalit.Tiranë.
- Loli. K. 1985. Veçori muzikore të valleve të minoritetit grek, Skena dheekrani
- Loli. K. 2003. Kaba dhe Avaze. Janinë,Greqi.
- Ministria e Kulturës. Shoqata Kulturore Artistike “Dropulli”: “Zonja e kostumeve” (Minoriteti grek në Shqipëri)<https://kultura.gov.al/en/shoqata-kulturore-artistike-dropulli-zonja-e-kostumeve-minoriteti-grek-ne-shqiperi/>
- Tase. P. & Loli. K. 2003. Naxhi Kasoruho, Mes këngëve dhe valleve të Dropullit. Tiranë.TOENA
- Γενικό επιτελείο Ελληνικού Στρατού (1913). Χάρτης Εθνογραφικός της Β. Ηπείρου (1913).
- Γιώτης Α. 2003. Εδεσματολόγιον Ηπείρου. Ελληνικάγράμματα.
- Καλιβρετάτης, Λεωνίδας. Η Ελληνική κοινότητα της Αλβανίας από την σκοπιά της ιστορικής γεωγραφίας καιδημογραφίας.
- Κοκολάκης, Μιχάλης. Η Τουρκική στατιστική της Ηπείρου στο σαλναμέ του1895.
- Μ.Β. Σακελλαρίου (επιμ.), Ήπειρος: 4000 χρόνια ελληνικής ιστορίας και πολιτισμού, Εκδοτική Αθηνών, Αθήνα 1997 ISBN 960-213-371-6, ISBN-13 978-960-213-371-2 [σειρά: Ιστορικοί ΕλληνικοίΧώροι]
- Μαμμόπουλου. Α. Χ. 2013. ΛΑΪΚΈΣ ΦΟΡΕΣΙΈΣ/ΑΝΔΡΙΚΗ ΕΝΔΥΜΑΣΙΑ/ ΦΟΡΕΣΙΑ ΤΗΣΔΡΟΠΟΛΗΣ.

- Παπα, Ευτυχία. Η Επαρχία Δρυινουπόλεως της Βορείου
Ηπείρου κατά την νεότερη περίοδο. Θεσσαλονίκη.
Παπαδόπουλος, Νίκος (1970). Η Δούβιανη της Δροπόλης
Β. Ηπείρου. Αθληνα.
- Παπαδόπουλος, Νίκος (1976). Η Δρόπολη της Βορείου
Ηπείρου κατά την Τουρκοκρατίαν (1430-1913).
Αθήνα.
- Παπαδόπουλου Κ.Ν. 2013. ΔΡΟΠΟΛΙΤΙΚΟΣ ΓΑΜΟΣ/ Η
ΣΤΟΛΗ ΤΗΣ ΔΡΟΠΟΛΙΤΙΣΣΑΣ ΝΥΦΗΣ.
- Χατζημιχάλη. Α. 2013. Η ΕΛΛΗΝΙΚΗ ΛΑΪΚΗ ΦΟΡΕΣΙΑ/
Η ΦΟΡΕΣΙΑ ΤΗΣ ΔΡΟΠΟΛΗΣ.

Dr. Anida KISI,
MA. Etleva DEMOLLARI
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës

ZGJIDHJE DIGJITALE PËR PËRMIRËSIMIN E OFERTËS TURISTIKE.

**Rasti i audioguidave të muzeut
“Shtëpia me gjethe”**

Abstract

This communication will bring the experience of the realization of audioguides in French by the students of the French language department for the national museum of secret surveillance «House of Leaves”. Their realization was entirely carried out by the students of the Scientific Master in Language and Intercultural and Tourist Communication within the framework of the FORMATHECO 2018-2019 project of the Agence Universitaire de la Francophonie (AUF) in partnership with the Faculty of Foreign Languages of the University of Tirana.

After briefly presenting some arguments in favor of the use of audioguides as an alternative means of

communication for museum visitors, we will detail the context in which the project was developed, its implementation methodology and its values.

Keywords: *audio guide, museum, communication, French.*

Diskutimi mbi «transformimet digjitale» në një mjedis muzeu shpesh mund të kthehet në një debat përçarës.

Puristët do të thonë se përvoja fizike e muzeut ofron diçka që digjitalja nuk mundet ta ofrojë; ndërsa të tjerë argumentojnë se është koha që muzetë të lëvizin me kohën dhe të rregullojnë reputacionin si «të ngurtë dhe konservatorë» duke parapëlqyer mjete që mund ta tërheqin brezin e ri.

Digjitalizimi është kthyer në kryefjalën e çdo sektori të jetës sonë. Teknologjitë e reja kanë hyrë tashmë gjerësisht në muzetë dhe në vendet e kulturës, kudo në botë por edhe në Shqipëri ku muzetë e kanë filluar tashmë transformimin e tyre digjital. Madje, vendet kulturore janë të përfshira në një garë për teknologji, qoftë në kontekstin e mirëpritjes së publikut, menaxhimit e të dhënave apo ruajtjen e trashëgimisë.

Sot gjithnjë e më shpesh vizitori mund të bashkëveprojë me veprat e një muzeu dhe të ketë qasje në më shumë të dhëna të shtuara përmes pajisjeve digjitale. Ky është një koncept që e tërheq publikun sepse e lejon atë ta bëjë më dinamike përvojën e tij.

Duke i kërkuar që të kryejë veprime të caktuara, vizitori bëhet aktor dhe jo më një spektator i thjeshtë i asaj që e rrethon (Deshayes, 2001). Teknologjia digjitale e lejon atë të mësojë dhe zbulojë në mënyrë argëtuese, angazhuese dhe ta bëjë përvojën tërheqëse për vizitorët që ndonjëherë janë shumë të rinj dhe vijnë në muze në kuadër të programit shkollor. Kështu krijohet një qasje krejt e re, mund të themi se digjitalizimi është përvoja muzeore e së ardhmes.

Ndër pajisjet e reja gjithëpërfshirëse të implementuara në Muzeun Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe” gjejmë në veçanti kodet QR, aplikacionet dhe audioguidat. Këto mjete sigurojnë qasje në përmbajtjen e shtuar siç është informacioni, ilustrimet dhe të dhëna të tjera që i shtojnë vlerë përvojës së vizitorit. Nga ana tjetër, tani është gjithashtu e mundur të bëhen ture virtuale të muzeut në 3D. Kjo praktikë i lejon vizitorët të zhyten në një univers ndërveprues dhe t’u japin atyre qasje në një përmbajtje më të pasur.

Pse të zgjedhim digjitalizimin e muzeve?

Përdorimi i pajisjeve digjitale në kontekstin kulturor duket se ofron shumë përparësi. Në muze, ato përfaqësojnë një metodë krejt të re të **ndërmjetësimit kulturor**, e cila i jep energji dhe i shoqëron vizitorët gjatë gjithë vizitës së tyre. Ato përbëjnë një mënyrë

inovative për ta eksperimentuar përmbajtjen dhe për të krijuar një **marrëdhënie me audiencën**.

Digjitalizimi i muzeve është gjithashtu një **përsheptues i vërtetë i zhvillimit (Soichot, 2012)**. Realizimi i audioguidave u lejon vizitorëve të zbulojnë të dhëna të cilat do të ishte e pamundur t'i dinin pa pasur një guidë profesioniste. Përveç kësaj, **risitë tërheqin kureshtarët dhe një audiencë më të gjerë**. Kjo është një mënyrë e shkëlqyer për t'i bërë muzetë të duken më argëtues dhe të këndshëm, dhe për të lejuar një grup të ri të publikut që t'i qaset kulturës.

Përparësitë e digjitalizimit të muzeve dhe institucioneve kulturore janë natyrshëm shumë interesante: ndërveprimet me publikun para, gjatë dhe pas vizitës, forcimi i përvojës kulturore arsimore dhe argëtuese. Por kufijtë e digjitalizimit të muzeve dhe institucioneve kulturore janë gjithashtu të pranishëm: ai kërkon burime të konsiderueshme, aftësi të reja të stafit, në veçanti punësimin e specialistëve të IT-së, buxhete për pajisjet dhe mirëmbajtjen, një rrezik nga „përparimi teknologjik“, dhe për publikun ekziston rreziku i zhgënjimit dhe i të ndjerit keq në rast të keqfunksionimeve (Mannion, Sabiescu, Robinson, 2015).

Departamenti i Gjuhës Frënge në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në bashkëpunim me Muzeun Kombëtar të Përgjimeve «Shtëpia me Gjethe» arritën

të realizonin një audioguidë në gjuhën frënge për muzeun.

Projekti i audioguidave lindi nga nevojat e përbashkëta të të dy institucioneve. Muzeu me një staf shumë të vogël, me buxhet të kufizuar, me orare të zgjatura që i duhet të presë një fluks vizitorësh të huaj gjithnjë në rritje e që dëshiron të përmirësojë shërbimin e ofruar dhe nga ana tjetër fakulteti që kërkon të zgjojë interesin e studentëve për dije duke i përfshirë në projekte, detyra e punë konkrete dhe duke u hapur edhe mundësi për punësim.

Projekti: «Realizimi i audioguidave për muzeun «Shtëpia e Gjetheve»

Audioguida është pjesë e mënyrave të reja të ndërmjetësimit që janë të disponueshme në muze dhe ekspozita duke ndihmuar në pavarësinë e vizitorëve. Përvoja frankofone dëshmon se audioguida është bërë tashmë e zakonshme në shumë struktura turistike e kulturore. Audioguida konsiderohet si një zëvendësuese e vizitave me udhërrëfyes, më ekonomike, dhe shërben për të zëvendësuar kartelat dhe tekstet. Kjo media e ndërmjetësimit, për momentin, mungon në muzetë shqiptarë.

Aktualisht, vendi ynë po përjeton një rritje të konsiderueshme të numrit dhe të interesit të turistëve të huaj kundrejt Shqipërisë dhe pasurive

të saj kulturore dhe natyrore. Kjo shoqërohet me shtimin e kërkesave për udhërrëfyes shumëgjuhësh dhe për informacione të dokumentuara kulturore. Konstatojmë se paraqitja e teksteve aktuale të promovimit ose komunikimit turistik është e pamjaftueshme, qofshin ato në format letër apo në atë elektronik. Përveç kësaj, burimet në frëngjisht janë të pakta dhe anglishtja mbetet gjuha kryesore e komunikimit turistik.

Shtëpia e Gjetheve ose Shtëpia Sekrete e Mbikqyrjes ka shërbyer për pothuajse gjysmë shekulli nën regjim totalitar për të monitoruar, spiunuar, burgosur dhe ekzekutuar shumë shqiptarë. Ajo përfaqëson një histori të dhimbshme të jetës njerëzore dhe torturës psikologjike të shqiptarëve që jetonin në një vend të mbyllur si në një „burg“. Ndërtesa, që nga vera e vitit 1943, bëhet selia e Gestapos në Shqipëri dhe qendra kryesore e marrjes në pyetje të policisë sekrete të shtetit nazist. Më 23 maj 2017, Muzeu Kombëtar “Shtëpia e Gjetheve” hapi dyert e tij për publikun, Kjo ndërtesë misterioze ka qenë mbuluar me gjethe për 45 vjet. Muzeu nuk ka udhërrëfyes në frëngjisht, gjë që shpesh çon në probleme të organizimit dhe të disponueshmërisë.

Masterinë „Gjuhë dhe Komunikimin ndërkulturor dhe turistik“ paraqet një nismë të ndërmarrë për t’u ofruar studentëve një formim që përshtatet me

kërkesat e tyre dhe plotëson prioritetet e kontekstit akademik në zhvillim, si dhe nevojat e mjedisit profesional (si ai i turizmit në Shqipëri) ku konstatohet një rritje në sektorët që lidhen me shumëllojshmërinë e kontakteve kulturore. Komponenti ndërkulturore i kurrikulës është thelbësor për të arritur një nivel të mirë të performancës duke pasur aftësi më të mira analitike dhe operacionale në format e reja socio-kulturore shqiptare të karakterizuara nga shkëmbimet, multikulturalizmi dhe diversitetit. Ky formim i lejon studentit të zhvillojë një profil përkatës të aftësive në lidhje me profesionin e tij të ardhshëm:

- Aftësi të kënaqshme gjuhësore përmes rrjedhshmërisë në gjuhën frënge dhe të paktën një gjuhë tjetër e huaj (komunikim / përkthim / interpretim / shkrim).
- Njohuri dhe aftësi që lidhen me fushën e komunikimit (forma, strategji, mjete, skenarë, etj.) dhe atë të interkulturalitetit (konteksti global / konteksti lokal).
- Njohuri dhe aftësi specifike në lidhje me turizmin dhe komponentët e tij, menaxhimin dhe marketingun, hartimin dhe zbatimin e projekteve, si dhe përdorimin e TIK-ut.

Cilat janë përfitimet nga projekti?

Ky projekt përfshiu studentët e Masterit Shkencor në Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik, si dhe ata të vitit të tretë Bachelor, dega Gjuhë dhe Komunikimi. Studentët kanë një zotërim të mirë të gjuhës franceze (niveli B1 / B2). Kurrikula e tyre përmban modulet e lidhura me komunikimin, kulturën dhe qytetërimin si: Historia e Francës, Qytetërimi Francez, Historia e Artit, Teoritë e Komunikimit, Komunikimi ndërkulturor, Komunikimi turistik, Strategjitë dhe teknikat e komunikimit etj. Profili i studentëve është mjaft homogjen në lidhje me aftësitë e tyre gjuhësore, ndërdisiplinore, shumëgjuhësore dhe socio-kulturore.

Në këtë projekt bashkëpunuan tri institucione: Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Muzeu Kombëtar „Shtëpia e Gjetheve“ në Tiranë dhe Radio Tirana International në frëngjisht

Projekti u realizua në tri faza:

1. Në fazën e parë veprimtaritë kryesore ishin: prezantimi i projektit: krijimi i grupeve të punës, vizita e parë e muzeut, drafti i parë i rrëfimit; prodhimi i pemës audioguide dhe shpërndarja e punës ndërmjet studentëve;
2. Në fazën e dytë u krye dokumentimi dhe puna me shkrim nga studentët si dhe rishikimi i teksteve që do të lexohen;

3. Në fazën e fundit u realizua regjistrimi audio i pjesëve të guides dhe publikimi i tyre.

Kjo përvojë profesionale ofroi për studentët realizimin e një produkti që del nga korniza klasike e detyrave universitare dhe i ballafaqoi me problematikat, kushtëzimet dhe përgjegjësitë e një pune në një kuadër profesional. Projekti pati si synim:

- Të zhvillojë “edukimin nëpërmjet kërkimit”
- Të nxisë frymën reflektuese dhe kritike të studentëve
- Të profesionalizojë studentët
- Të përfshijë studentët në një projekt bashkëpunues
- Të mobilizojë njohuritë e transferueshme edhe në aktivitete të tjera të fushës turistike

Ne e konsiderojmë të rëndësishme që studentët të njihen me shumëllojshmerinë e aftësive dhe hapësirave që mund t’u shërbejnë në tregun e punës. Këto përvoja janë shumë formuese. Studentët kanë mundësi të përballen me përmbushjen e objektivat si në botën reale të punësimit: duke punuar në ekipe dhe me partnerë, duke respektuar afatet dhe planifikimin rigoroz, etj. Në nivelin universitar, ky projekt afirmoi mbështetjen dhe përfshirjen e studentëve në projekte dhe veprimtari të aktorëve kulturorë dhe turistikë (si

muzetë, mediat) si dhe vullnetin e shkëmbimeve dhe bashkëpunimeve me partnerë në fushën profesionale. Prej punës së kryer për realizimin e këtij projekti studentët përfituan: aftësi ligjërimore dhe gjuhësore (në frëngjisht), aftësi teknike të informacionit dhe komunikimit, kompetenca kulturore dhe kompetenca ndërdisiplinore

Vlera e shtuar e projektit

Si rezultat i punës së kryer, muzeu kombëtar i përgjimeve «Shtëpia e gjetheve» zotëron të gatshme për përdorim audioguidën e plotë në gjuhën frënge, e cila mund të përdoret për të shoqëruar në mënyrë të pavarur vizitorët. Është me vend të vëmë në dukje se frëngjishtfolësit janë në krye të listës së vizitorëve të muzeut dhe pasja e një audioguide lehtëson dhe plotëson punën e udhërrëfyesit në frëngjisht.

Projekti ynë nxiti interesin e Ambasadës së Italisë në Shqipëri duke mbështetur Departamentin e Gjuhës italiane në realizimin e audioguides në italisht, duke marrë për bazë punën e kryer në kuadër të projektit tonë.

Projekti, sipas vlerësimit tonë, jo vetëm i ka plotësuar tërësisht objektivat e tij, por i ka tejkaluar ato duke shërbyer si nxitës dhe përhapës i veprimtarive të tjera të kryera nga studentë e pedagogë të fakultetit tonë, ku ndërthuren njohuritë akademike me përvojën në terren,.

BIBLIOGRAFI

Olivier Soichot, «Suivez l'(audio)guide !», *La Lettre de l'OCIM* [En ligne], 132 | 2010, mis en ligne le 01 novembre 2012, consulté le 29 septembre 2022. URL: <http://journals.openedition.org/ocim/396>; DOI: <https://doi.org/10.4000/ocim.396>

Sophie Deshayes, «Interprétation du statut d'un audioguide», *Études de communication* [En ligne], 24 | 2001, mis en ligne le 19 octobre 2009, consulté le 28 septembre 2022. URL: <http://journals.openedition.org/edc/995>; DOI: <https://doi.org/10.4000/edc.995>

Shelley Mannion, The British Museum, UK, Amalia Sabiescu, RMIT Europe, Spain, William Robinson, British Museum, UK, "An audio state of mind: Understanding behaviour around audio guides and visitor media." MW2015: Museums and the Web 2015. Published February 1, 2015. Consulted September 29, 2022. <https://mw2015.museumsandtheweb.com/paper/an-audio-state-of-mind-understanding-behaviour-around-audio-guides-and-visitor-media/>

AUF: <https://www.auf.org/nouvelles/actualites/deformation-a-professionnalisation-etudiants-albanais-realisation-daudio-guides-francais/>

Muzeu, "Shtëpia me gjethe": <http://muzeugjethi.gov.al/audioguida/>

Prof. asoc. Dr. Lindita LATIFI

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë

Universiteti i Tiranës

SHKRIME TË VJETRA TË SHQIPES GJATË SUNDIMIT OSMAN. RIVLERËSIMI I TYRE NË DOBI TË TURIZMIT KULTUROR

Abstract:

In our paper, we will specifically focus on the written material culture of Albanian, as an important part of the cultural heritage. The Albanian language has always attracted the curiosity and attention of foreign researchers, as well as travelers and tourists who have visited these lands since early times.

Throughout the past centuries, as a result of the lack of an official alphabet, the Albanian language has been written with different alphabets (Latin, Arabic and Greek). As part of the material cultural heritage, the written heritage of Albanian and its rich fund, written with these alphabets (dictionaries and primers), arousing the curiosity of tourists, can be part of cultural tourism.

In this context, we think that the time has come to turn our attention to the evidence and

presentation of the written heritage as an integral part of the cultural heritage. Therefore, we think that the time has come to have a Museum of old Albanian writings, dictionaries and its primers. Such a museum would present the journey of Albanian through the alphabets with which it was written over the centuries. Such a museum would be another evocative element for cultural tourism.

Keywords: *language, cultural heritage, museum, alphabet*

Tema bosht e kësaj konference qe mjaft ndjellëse e na nxiti të trajtojmë një çështje që është trajtuar përgjithësisht pak, për të mos thënë aspak, në fushë të trashëgimisë kulturore shkrimore të shqipes. Në punimin tonë do të ndalojmë në mënyrë të veçantë në kulturën materiale shkrimore, si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore.

Gjuha shqipe gjithmonë ka tërhequr kureshtjen dhe vëmendjen e jo vetëm studiuesve të huaj albanologë, por edhe të udhëtarëve e turistëve që kanë vizituar që herët këto troje. Është fakt se që shekuj më parë prej tyre janë mbajtur shënime, ditarë, përshkrime e madje janë hartuar edhe fjalorthë e doracakë dy, tre e më shumë gjuhësh.

Përgjatë shekujve XVII-XIX për hartimin e fjalorëve u përdorën alfabetë të ndryshme, ato u shkruan me alfabet latin, arab dhe grek. Për studiuesin

Osman Myderrizi¹ të tria këto leksikografi dy ose tri gjuhësh si qëllim kryesor patën të ndihmonin shqiptarët për të mësuar një gjuhë të huaj ose të huajt për të mësuar gjuhën shqipe. Siç thekson me të drejtë O. Myderrizi “Në Rilindje leksikografia jonë ndërroi drejtim...”², pasi në këtë kohë u synua të hartoheshin fjalorë shpjegues të shqipes me qëllim mbledhjen e pasurisë leksikore të saj. Mund të themi se përgjatë periudhave të ndryshme këto vepra leksikografike u hartuan kryesisht nga misionarë të huaj, albanologë të huaj të njohur, patriotë e studiues shqiptarë.

Bazuar në të dhënat që japin Gaetano Pettrona në “*Popopo, lingua e letteratura albanese*”, Osman Myderrizi në artikujt e tij, Jup Kastrati në “*Histori e Albanologjisë*” e të tjerë, nëse paraqesim një statistikë të shkurtër të këtyre veprave leksikografike, pavarësisht madhësisë së tyre, mund të rendisim një numër relativisht të madh të fjalorëve shkruar me alfabetë të ndryshme:

Në **shekujt XV-XVII** ndeshim këto fjalorë: Fjalorthi shqip- gjermanisht i **Arnold von Harffi**, që daton më **1497**; **Pjetër Mazrreku** në një relacion të vitit **1633** përfshin një fjalorth italisht-shqip me 32 fjalë; **Frang Bardhi** më **1635** me fjalorin “*Dictionarium latino-*

¹ Myderrizi, Osman; Fjalori shqip-tyrquisht I H. Ali Ulqinakut,, “Studime Filologjike”, Tiranë, Nr.3, 1961, fq 129.

² Myderrizi, Osman; Fjalori shqip-tyrquisht I H. Ali Ulqinakut,, “Studime Filologjike”, Tiranë, Nr.3, 1961, fq 129.

epiroticum” që përmban rreth 5000 fjalë latine dhe 2544 fjalë shqipe; në vitin 1678 fjalori “*Dictionarium epiroticum*” nga misionari italian në Shqipërinë e Veriut, **Leone Da Cittadella**³; në vitin 1693 kemi fjalorin prej pesë gjuhësh: **italisht-kroatisht-greqisht-shqip-turqisht** nga **Julia Balovica**⁴, ndërsa më 1694 fjalori shqip-italisht e italisht-shqip i klerikut **Nilo Catalano**, kryepeshkop i Durrësit.⁵

Shekulli XVIII na ofron një numër më të madh fjalorësh që ishin përgjithësisht dy gjuhësh dhe na shfaqen të hartuar përmes alfabeve të ndryshme. Alfabeti latin që ishte përdorur gjatë shekullit XVII vazhdonte akoma, por krahas tij u vunë në përdorim dhe alfabeti grek e arab. Mes tyre janë: Fjalori italisht-shqip i **Da Lecce** i shkruar më 1702⁶; Fjalori italisht-shqip i Manastirit të **Grotaferratës** (*Dizionario Italiano & Albanese per Alfabeto*)⁷; Fjalori greqisht-shqip me 110 fjalë dhe fjalori shqip-greqisht me

³ Benedikt Dema, *Shtypi françeskan në Shqypni, Hylli i Dritës*, nr 12, 1940, Shkodër, fq 609.

⁴ Leka, Ferdinand; Një material leksikografik historik për gjuhën shqipe: Fjalorthi italisht - kroatisht - greqisht - shqip - turqisht J. Balloviqitivitit 1693; *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1994, nr 5-6.

⁵ Myderrizi Osman, *Fjalorishqip-turqishti H. Ali Ulqinakut*, “Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore”, Tiranë, 1961, nr. 3, f. 117.

⁶ Myderrizi Osman, *Fjalori shqip-turqishti H. Ali Ulqinakut*, “Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore”, Tiranë, 1961, nr. 3, f. 117.

⁷ Myderrizi Osman, *Fjalorishqip-turqishti H. Ali Ulqinakut*, “Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore”, Tiranë, 1961, nr. 3, f. 117.

1533 fjalë të lëna dorëshkrim nga **Kostandin Berati**, që shkroi shqip me alfabet grek; Fjalori i **Teodor Kavaliotit**⁸ greqisht-arumanisht-shqip i shkruar me alfabet grek, që u botua për herë të parë në vitin 1770 dhe gjendej në vëllimin Protopiria; Fjalori italisht-shqip me 10.000 fjalë nga **Nikoll Keta**⁹ që përfundoi në vitin 1779; Fjalori italisht-shqipiautorit italian **Bonaventura Prucher**,¹⁰ që e hartoi me qëllim për t'i ardhur në ndihmë misionarëve të Kelmendit; "Fjalor shumëgjuhësh i dijetarit spanjoll **Lorenzo Hervas Panduro**¹¹ në vitin 1787, ku përfshihen më shumë se 150 gjuhë e ku gjenden edhe 63 fjalë të gjuhës shqipe të përdorimit të përditshëm, të cilat i emërton si epirotike, shqipe dhe "greko-siciliane"; Fjalori i **Evlija Çelebiut** turqisht-shqip me alfabet arabo-osman.

Në **shekullin XIX**ndeshim këta fjalorë: Fjalori greqisht- arumanisht- bullgarisht- shqip i hartuar në vitin 1802 nga **Danil Voskopojari**; "Fjalor dygjuhësh i greqishtes dhe i shqipes popullore" në vitin 1809 i hartuar nga **Marko Boçari**, ku pjesa e fjalëve shqip është e shkruar me alfabet grek; Fjalorët arbërisht-italisht dhe italisht-arbërisht i **Andrea Darës**¹² përgjatë viteve 1867-1868 etj.

⁸ Myderrizi Osman, *Fjalorishqip-turqishti H. Ali Ulqinakut*, "Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore", Tiranë, 1961, nr. 3, f. 117.

⁹ Petrotta Gaetano, *Popopo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931

¹⁰ Petrotta Gaetano, *Popopo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931

¹¹ Petrotta Gaetano, *Popopo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931

¹² Petrotta Gaetano, *Popopo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931

Ky shekull sjell një numër më të madh veprash leksikografike sidomos nga albanologët e huaj, nga **Martin Leake** në vitin 1814¹³, fjalorth frëngjisht-shqip i **Pouqueville** në vitin 1820, **Xylandri** në vitin 1835 me fjalorët gjermanisht- shqip dhe shqip- gjermanisht, **Fallot** dhe **Ackerman** në vitin 1836 me dy glosarët e tij. “Glossaire latin-albanais” dhe “ Glossaire grec romaique-albanais”, misionari françeskan në Shqipëri **Luca da Montegiove** me Dizionario Italiano-Albanese lënë dorëshkrim në vitin 1848¹⁴, më pas **Johan Georg von Hahn**¹⁵, meFjalorin shqip-gjermanisht dhe atë gjermanisht-shqip, fjalori i **Pedërsenit**¹⁶, **GustavMayer** me “Fjalori etimologjik” në vitin 1891, **Bernard Bilota** nga Kalabria në vitin 1888 me “Fjalor filologjik i gjuhës shqipe”¹⁷, fjalorët e misionarëve italianë **Francesko Rosi dhe Xhakomo Jung**¹⁸, fjalori i **Vajgand**¹⁹ shqip- gjermanisht e gjermanisht- shqip, fjalorët e **Anton Buxeti, Anxhelo**

¹³ Petrotta Gaetano, *Popopo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931

¹⁴ Petrotta Gaetano, *Popopo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931

¹⁵ Myderrizi Osman, *Fjalorishqip-turqishti H. Ali Ulqinakut*, “ Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore”, Tiranë, 1961, nr. 3, f. 118.

¹⁶ Myderrizi Osman, *Fjalorishqip-turqishti H. Ali Ulqinakut*, “ Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore”, Tiranë, 1961, nr. 3, f. 118.

¹⁷ Petrotta Gaetano, *Popopo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931

¹⁸ Petrotta Gaetano, *Popopo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931

¹⁹ Myderrizi Osman, *Fjalori shqip-turqishti H. Ali Ulqinakut*, “Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore”, Tiranë, 1961, nr. 3, f. 118.

Leoti, Fulvio Kordinjano, Lambercit²⁰, e gjuhëtari kroat **Henri Bariç**, si dhe fjalorët frëngjisht-shqip të **Sotir Kolea, Kolë Kamsit, Luigj Gurakuqit** apo të **Gjergj Pekmezi**.

Koha e hartimit të gjithë këtyre fjalorëve i takon periudhës së sundimit osman. Sundimi osman në Shqipëri, ashtu si edhe në vende të tjera të Ballkanit, zgjati për një kohë relativisht të gjatë, ai daton nga viti 1384 e deri në vitin 1912. Sigurisht që ky sundim pati ndikimet e veta të cilat reflektohen sot në mjaft elementë të trashëgimisë kulturore materiale, reflektohen në arkitekturën e ndërtesave, odave, pazareve, sokakëve, kalldrëmeve, kullave të sahatit, haneve, teqeve, medreseve, xhamive, urave, çeshmeve; reflektohen në ndikimet e dukshme në kulinari, veshje, folklor, e madje edhe në ndikimet gjuhësore e gjurmët e shumta që ka lënë në leksikun e shqipes.

Për trashëgiminë kulturore materiale që i takon periudhës osmane e që vjen sot si rezultat i saj është folur jo pak dhe janë hartuar mjaft studime të kënaqshme. Për fat të keq është lënë disi në harresë ose ka shpëtuar nga vëmendja çështja e studimit dhe prezantimit si duhet të trashëgimisë së kulturës materiale shkrimore të kësaj periudhe relativisht të rëndësishme në historinë e Shqipërisë.

²⁰ Petrota Gaetano, *Popopo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931

Përgjatë shekujve të kaluar, si rezultat i mungesës së një alfabeti zyrtar, gjuha shqipe është shkruar me alfabete të ndryshme. Mes alfabeteve të përdorura mund të numërojmë alfabetin latin, grek dhe atë arab. Alfabeti arab erdhi si rezultat i kontaktit të drejtpërdrejtë me osmanët. Ai është përdorur pas përdorimit të alfabetit latin me të cilin u lëvrua letërsia e vjetër shqipe. Kështu gjurmë të përdorimit të këtij alfabeti gjejmë që nga fundi i shek. XVII, por përdorimi në masë i tij diktohet në fillim të shek. XVIII. Ky alfabet u përdor deri nga fundi i shekullit XIX.

Fillimisht poetët e parë që iu afruan kësaj kulture shkruan në osmanisht. Ka nga ata që kanë hyrë në antologjitë e letërsisë së vjetër turke. Më pas të njëjtët e të tjerë autorë filluan të shkruajnë poezinë shqipe me alfabet arab, pra gjuhën shqipe me alfabet arab. Po ndaloj në këto shkrime, pasi është fakt që ato janë lënë jashtë vëmendjes së filologëve, qoftë për shkak të paragjyqimeve ndaj autorëve që u etiketuan si bejtexhinj, qoftë edhe për shkak të mosnjohjes së alfabetit arabo-osman. Një gjë e tillë theksohet edhe nga studiuesi Osman Myderrizi në të gjitha punimet e tij për shkrimet e shqipes me alfabet arab.

Ajo që etiketohet si letërsi e bejtexhinjve në të vërtetë është fenomeni i të shkruarit me alfabet arab, i njohur si Alhamiado, që gjeti përhapje fillimisht në Spanjë, Portugali, e mandej u shtri edhe në vende si Bosnje e Shqipëri. Alhamiado rrënjët i pati në

gadishullin Iberik, në Spanjë më së shumti, por dhe në Portugali si pasojë e pushtimit arab në këto vende (711-1492).

Fenomeni Alhamiado u manifestua edhe në vende të tjera të Evropës. Nëse në Spanjë dhe në Portugali ndikimi vinte nga pushtimet arabe, në pjesë të tjera të Evropës ku u shfaq të shkruarit me alfabet arab të gjuhëve përkatëse, ndikimi erdhi si pasojë e pushtimit turk.

Robert Elsie në një artikull të tij *"Albanian literature in the moslem tradition eighteenth and early nineteenth century Albanian writing in Arabic script"* shpjegon se e gjithë letërsia me alfabet arab nisi në Spanjë. Kalimin nga turqishtja, persishtja, arabishtja tek shqipja si mjet i shprehjes letrare përfundoi me atë që njihet si letërsi alhamiado që shënon një letërsi vendase të shkruar me alfabet arab dhe të ndikuar nga kultura islame. Elsie e vlerëson dhe i sheh me shumë rëndësi përpjekjet e para në fillim të shekullit XVIII, të shkrimtarëve të formuar me kulturë islame të cilët vendosën për tu shprehur në gjuhën vendase dhe jo në të orientit. Këto të fundit madje ai i barazon me rëndësi të njëjtë me kalimin që bënë nga latinishtja në shqip autorët e vjetër të shekullit XVI-XVII.

Por rëndësia e këtyre shkrimeve është shumë më e madhe nga ç'mund të mendohet. Kjo pasi këto vepra letrare shoqërohen me fjalorë të shqipes shkruar me alfabet arab, fjalorë që për fat të keq, për shkak

të etiketimit jo të drejtë të letërsisë janë lënë jashtë vëmendjes. Ato janë përgjithësisht fjalorë të shkruar sipas metrikes perse, në vargje, por edhe me rend alfabetik dhe prezantojnë një tablo mjaft interesante të gjendjes së dialekteve dhe të folmeve të ndryshme të shqipes në një periudhë kohore gati 200 vjeçare. Përmes tyre ne mund të hartojmë një atlas gjeografik të dialekteve të shqipes së atyre shekujve, pasi autorët u përkasin trevave të ndryshme: Shkodër, Dibër, Ulqin, Lezhë, Elbasan, Berat, Korçë, Gjirokastrë, Delvinë, Konispol etj.....

Këtu mund të përmendim fjalorët e **Shemimiut**²¹, **Nezim Frakullës**²², **Myslym Hoxhës**, tre fjalorët e **Hafiz Ali Ulqinakut**²³ e mjaft të tjerëve.

Hulumtimi i arkivave, transliterimi i këtyre veprave letrare dhe dokumenteve shkrimore, botimi i fjalorëve të gjetur të paktën deri me tani etj., do ta ndihmonin shumë albanologjinë, pasi do ta furnizonin me një material gjuhësor që do të lejonte t'u hapet udha mjaft studimeve analizuese, si në planin sinkronik ashtu edhe në atë diakronik të shqipes.

²¹ Myderrizi Osman, *Fjalori shqip-turqishti H. Ali Ulqinakut*, "Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore", Tiranë, 1961, nr. 3, f. 121.

²² Myderrizi Osman, *Fjalorishqip-turqishti H. Ali Ulqinakut*, "Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore", Tiranë, 1961, nr. 3, f. 119.

²³ Ushaku Ruzhdi, "*Vendi i leksikut të Fjalorit shqip-turqisht të Hafiz Ali Ulqinakut në rrafshin sinkronik të së folmes së sotme të Ulqinit*", Kërkime-filologjike, Rilindja, Prishtinë, 1981, f. 180-199.

Veç kësaj janë lënë plotësisht në harresë me dhjetëra abetare të shqipes shkruar me alfabet arab, e ndoshta edhe me alfabet grek e latin. Studimi i këtyre abetareve që në fakt janë hartuar si “gjithëditurore” paraqet interes të veçantë dhe është një dije e munguar për historikun e shkrimit të shqipes.

Mund të përmendim këtu nga Pashko Vasa “*Alfabetare e gjuhësë shqip*”²⁴; “*Shkronjëto e gjuhësë shqip*”²⁵ e Sami Frashërit; “*Abetarja shqip (1869)*” e Daut Boriçit²⁶; “*Alfabetare e gjuhës shqipe (1879)*” e Panajot Kupitorit; “*Abetarja e gjuhës shqipe (1896)*” e De Radës, e shumë të tjera si këto. Mjafton të theksojmë se vetëm me alfabet arab janë hartuar rreth 14 abetare.

Veç tyre, sidomos në shekullin XIX janë hartuar edhe mjaft gramatika e tekste të tjera mbi gjuhën shqipe. Gjuha shqipe dhe shkrimi i saj ka qene motoja e punës së atdhetarëve shqiptare ndër shekuj. Sami Frashëri që në vitin 1879 në veprën e tij do të theksonte se: “Kòmbetë mbàhenë me gjúhëtë; një kòmp që humbét gjúhën e vét, është’i húmbur’ e i haruàrë; që me të húmburit të gjúhës së tî është’ i húmburë edhe ay vétë. Shënj’ e kombërisë është gjuh;

²⁴ Agalliu, Fatmir; “*Shkronjëto e gjuhësë shqip*” e S. Frashërit – *vepër e rëndësishme e gramatologjisë shqiptare*, “*Studime filologjike*”, nr. 3, Tiranë, 1979.

²⁵ Frashëri, Sami; *Gjuha Shqip*, “*Alfabetare e Gluhësë Shqip*”, Ndë Konstandinupojë mbë 1879.

²⁶ Kastrati, Jup; *Abetarja shqipe e Daut Boriçit e vitit 1869*, “*Mësuesi*”, Tiranë, 18 shtator 1964, nr. 38.

çdo komp mbahet me gjuhët; ata njerës, që harojnë a lënë gjuhën' e tyre e flasinë një tjetër gjuhë, me kohë bëhenë njerëzit' e ati kombi q'i flasin gjuhënë e dalinë me kombëri' e tyre"²⁷

Si pjesë e trashëgimisë kulturore materiale, trashëgimia shkrimore dhe fondi i pasur i këtyre veprave gjuhësore (fjalorë, abetare e gramatika), një pjesë e të cilave janë hartuar nga udhëtarë e studiues të huaj, e një pjesë tjetër nga studiues e atdhetarë shqiptarë të kohës, mund të ngjallin kureshtjen e turistëve, të cilët gjithmonë kanë treguar e tregojnë interes për shqipen, si një gjuhë e veçantë e që mbetet interesante për ta.

Deri me sot është punuar mjaft mirë për evidentimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore materiale. Në këtë kontekst mendojmë se ka ardhur koha ta kthejmë vëmendjen në evidentimin dhe prezantimin edhe të trashëgimisë shkrimore, si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore.

Në periudha të caktuara dhe në ditë simbolike kohët e fundit janë bërë prezantime të shkrimeve të vjetra të shqipes në Muzeun Kombëtar ose në Bibliotekën Kombëtare, por kjo nuk mund t'i shërbejë në masën e duhur turizmit kulturor.

Ndaj mendojmë se ka ardhur koha të kemi
Muzeun e Shkrimeve të Vjetra të Shqipes, e

27 Frashëri, Sami; *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë* "Naim Frashëri", Tiranë, 1962.

Fjalorëve, Abetareve dhe Gramatikave të saj. Një muze i tillë jo vetëm do të mbushte një zbrazëti në dijen tonë, por gjithashtu do të ishte një tjetër element atraktiv e ndjellës për turizmin kulturor. Zotërojmë një material të gjerë shkrimor të shtrirë në rrjedhën e shekujve, material që herë pas here mund të furnizohet edhe me gjetje të reja.

Në fakultetin tonë, në departamentet e gjuhësisë e të historisë, mendojmë se i kemi kapacitetet e duhura intelektuale, që mund të kontribuojnë në këtë çështje. Shpresojmë që së shpejti ta prezantojmë këtë iniciativë në institucionet e duhura dhe të gjejmë mbështetjen e tyre, për ta vënë në jetë atë.

BIBLIOGRAFIA

- Agalliu, Fatmir; “Shkronjëto e gjuhëseshqip” e S. Frashërit – vepër e rëndësishme e gramatologjisë shqiptare, *Studime filologjike*, nr. 3, Tiranë, 1979.
- Dema, Benedikt; “Shtypi françeskan në Shqypni, Hylli i Dritës”, nr 12, 1940, Shkodër.
- Frashëri, Sami; “Gjuha Shqip”, *Alfabetare e Gluhësë Shqip*, Ndë Konstandinupojë mbë 1879.
- Frashëri, Sami; “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë», Naim Frashëri, Tiranë, 1962.
- Kastrati, Jup; «Abetarja shqipe e Daut Boriçit e vitit 1869», Mësuesi, Tiranë, 18 shtator 1964, nr. 38.

- Leka, Ferdinand; «Një material leksikografik historik për gjuhën shqipe:Fjalorthi italisht-kroatisht-greqisht-shqip-turqisht i J. Balloviqit i vitit 1693»; Hylli i Dritës, Tiranë, 1994, nr 5.
- Myderrizi Osman, “Fjalori shqip-turqisht i H. Ali Ulqinakut”, Buletini Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore, Tiranë, 1961, nr. 3.
- Petrotta Gaetano, “Popopo, lingua e letteratura albanese”, Palermo, 1931.
- Ushaku Ruzhdi, “Vendi i leksikut të Fjalorit shqip-turqisht të Hafiz Ali Ulqinakut në rrafshin sinkronik të së folmes së sotme të Ulqinit”, Kërkime filologjike, Rilindja, Prishtinë, 1981.

Prof. Asoc. Dr. Ardiana HYSO (KASTRATI)

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

**TRASHËGIMIA KULTURORE
SHQIPTARE NË KURRIKULAT
E KOMUNIKIMIT TË
DEPARTAMENTIT TË GJUHËS
FRËNGE**

Abstract

Based on the emerging and continues rising interest in intercultural communication and tourism, 15 years ago the faculty of foreign languages has reviewed and developed new curricula that targeting objectives beyond linguistic competencies. Those curricula were conceived to develop skills and knowledge in the areas of the strategies of communication, the cultural heritage and touristic resources and were introduced as the program of the Intercultural and Touristic Communication. In this context, this paper aims to explore the weight that the national cultural heritage as an important body of knowledge for the students of the French

language, hold in the university programs of two studies' cycles. To collect the necessary data for such analysis, the elements of cultural heritage were identified, classified and analyzed based on the different categories of cultural heritage for the selected modules. Particular focus was set on the treatment of cultural heritage subjects in the degree theses or other research papers prepared by students of both levels of studies. The most relevant data was produced by interviews conducted with professors who teach the subjects that are an object of this study.

The analyse discovered a consolidated trend of and rising interest the students have in the themes of cultural heritage. The analyse of data noticed that this is due to the affinity the students have with these subjects and as the consequence the comfort in preparing the research. In addition to this, they perceives practical benefits from the learning outcomes on these subjects and were projecting themselves as touristic guides or cultural mediators in the future. The research found that both students and academic staff agreed that the program of intercultural communication and tourism enhances the linguistic knowledge at the professional level, introduces the basis of cultural heritage as an element of the national identity, and builds practical skills which can be applied easily in the work. The research has found out that while the existing program provides a solid theoretic knowledge on the area of tourism, the related subject as the

themes of cultural heritages are taught in a basic level being only descriptive and informative and lack advanced scientific knowledge. It is explainable that the curricula may cover in-depth only the core and facultative subjects, while the students seem not ready to use advanced scientific methods in their research work. As it remains an obstacle for the advanced students with higher objectives than the average, the ongoing improvement of bibliographies and the strengthening of relationship with the research institutes, with the department of cultural heritage or other organizations that owns useful data on these subject, could be a practical solution to this issue.

Keywords: *curriculum university, cultural heritage, tourism, interdisciplinary studies*

Gjatë këtyre dy dhjetëvjeçarëve të fundit sistemi Universitar shqiptar ka pësuar ndryshime të konsiderueshme në organizimin e studimeve, përmbajtjen e programeve apo larminë e diplomave. Në rrekje për një harmonizim sa më të mirë me standardet kurrikulare e profilet e universiteteve fqinje, pjesë të Konventës së Bolonjës, si dhe duke i dhënë përparësi karakterit ndërdisiplinar të edukimit të sotëm apo dhe përshtatjes se ketij te fundit me tregun e punës, që prej vitit 2008, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (FGjH), filloi implementimin e profileve të reja, përrpos atij tradicional gjuhësor.

Duke synuar një koherencë dhe bashkëkoordinim sa më të mirë të studimeve të larta dhe tregut të punës, gjatë fazës përgatitore nga ana e pedagogëve të fakultetit tonë, u vlerësua interesi që paraqiste fusha e Komunikimit ndërkulturor dhe ajo e Turizmit, me potencialin e tyre përballë një publiku turistik gjithnjë e në rritje.

Zhvillimet e reja të tregut që shënuan rritje të peshës së Komunikimit dhe turizmit në ekonominë shqiptare, si dhe interesi i shtuar i të gjithë aktorëve në këtë drejtim, shërbyen si nxitës për universitetin për të punuar drejt formimit të profesionistëve me aftësi edhe në këto fusha. Në këtë kontekst, FGJH-ja rikonceptoi kurrikulat e reja që shkonin përtej kompetencave gjuhësore, duke zhvilluar njohuri dhe aftësi në fushat e strategjive të komunikimit, të trashëgimisë kulturore dhe burimeve turistike nën profilin **Komunikim ndërkulturor dhe turistik**.

Objektivi kryesor i kësaj kumtese është hulumtimi i peshës që trashëgimia kulturore shqiptare, si një fushë me interes e pritshmëri të lartë për studentët e gjuhës frënge, zë në programet e dy cikleve të studimit. Kjo do të realizohet kryesisht përmes identifikimit të elementeve të trashëgimisë kulturore gjatë analizës së përmbajtjes së moduleve dhe analizës së kategorive të ndryshme të trashëgimisë kulturore. Informacioni i marrë do të plotësohet me një vlerësim të nivelit të trajtimit të kësaj fushe përmes temave të diplomës

dhe angazhimeve të tjera kërkimore të studentëve. Në vijim, kjo kumtesë do të synojë të vlerësojë e kuptojë dhe kapacitetet e studentëve në eksplorimin e kësaj fushe në drejtim të përdorimit të metodologjisë kërkimore të përshtatshme, vlerësimin e burimeve studimore, qasjen e studentëve në to, si dhe nivelin e mbështetjes nga institucionet e specializuara.

Metodologjia

Në përgatitjen e këtij kërkimi, u bazuam në të dhënat dhe informacionin e nxjerrë nga shqyrtimi i kurrikulave të programeve mësimore si dhe punëve kërkimore të realizuara nga studentët gjatë katër viteve të fundit. Këto të dhëna u plotësuan dhe u konfirmuan përmes intervistimit të profesorëve të lëndëve si dhe të studentëve, të përfshirë në këto programe dhe që kanë kryer punë kërkimore lidhur me objektin e këtij kërkimi.

Prania e trashëgimisë kulturore në programet mësimore.

Viti i tretë Bachelor në programin profilizues **Gjuhë frënge dhe Komunikim**, përveç lëndëve të formimit të përgjithshëm gjuhësor e letrar, synon njohjen a orientimin e studentëve me baza apo elemente të lëndëve të specialitetit. Ky profil hyrës

rezulton ndër vite i kërkuar, pasi u vjen në ndihmë studentëve për të vendosur më pas mbi interesin apo vazhdimësinë e tyre në profilin e Masterit shkencor: **Komunikim ndërkulturor e turistik.** Masteri shkencor përmban katërmbëdhjetë module të cilat janë të karakterit të përgjithshëm, të karakterit profesional, lëndë me zgjedhje, si dhe stazhin profesional.

Lëndët e specialitetit zhvillohen në frëngjisht dhe synojnë zhvillimin e kompetencave komunikuese në kontekst profesional. Modulet me zgjedhje u japin mundësi studentëve të thellojnë njohuritë në fushën e tyre të parapëlqyer dhe të plotësojnë formimin e tyre në fushën e komunikimit, të historisë, gjeografisë, etnografisë, arkeologjisë dhe antropologjisë kulturore.

Stazhi profesional tremujor mundëson njohjen nga afër me realitetin profesional, konfrontimin e njohurive teorike me anën praktike, duke u dhënë mundësinë studentëve të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe profesionale. Raporti i stazhit është dëshmi e reflektimit kritik të problematikave të ndeshura në terren dhe e zhvillimit të aktiviteteve. Studimet përmbyllen me një temë diplome në fushën e kulturës, letërsisë frënge e komunikimit turistik. Përgatitja e saj flet për një gamë të gjerë kompetencash si kërkimi, mbledhja e të dhënave, analiza, aftësia për të prezantuar, sintetizuar, interpretuar e nxjerrë përfundime shkencore.

Ndër lëndët profilizuese në programin Bachelor, u evidentuan katër syresh, që trajtojnë apo cekin tema të trashëgimisë kulturore (*Teknika të shprehjes dhe Komunikimit, Histori arti, Qytetërim shqiptar dhe Bazat e antropologjisë*). Në ciklin e studimeve Master prania e lëndëve që përmbajnë elemente dhe tema të trashëgimisë kulturore është më e dukshme. Nga katërmbëdhjetë lëndë në total, gjashtë prej tyre përmbajnë informacione apo prekin e trajtojnë tema të Trashëgimisë kulturore, më saktësisht në lëndët (*Ekonomi e aplikuar në kulturë dhe turizëm, Letërsi dhe Kulturë, Komunikim Turistik, Histori dhe Gjeografi e Ballkanit, Arkeologji dhe etnografi dhe antropologji kulturore*).

Nga të dhënat e mësipërme, në pamje të parë, të krijohet ideja se programi bachelor nuk i trajton në mënyrë të thelluar temat e trashëgimisë kulturore. Një pëerpjekje e mirë shihet në përmbajtjen e detyrave të kursit të studentëve në lëndët **Teknika të shprehjes dhe Bazat e antropologjisë**. Në fakt, nuk mund të presim që tema të natyrave të specializuara të përfshihen në lëndë që kanë si qëllim të sigurojnë njohuri bazë në fusha të caktuara. Shumë prej tyre janë lëndë të formimit të përgjithshëm, ndaj nuk mund të nisemi nga numri i vogël i lëndëve (katër syresh), për të arritur në konkluzionin se trashëgimia kulturore nuk është mjaftueshëm e pranishme në programin Bachelor.

Raporti i përmbysur në programin Master konfirmon logjikën e hipotezës së mësipërme, pasi natyra e specializuar e njohurive që jepen në këtë program, mundëson edhe integrimin e temave të veçanta nga fusha ndërdisiplinore siç është dhe kjo e trashëgimisë kulturore. Ndaj, mund të themi se kjo e fundit ka një prani të konsiderueshme në programet e trajtuara në këtë kumtesë.

Gjatë këtyre viteve është parë një interes i shtuar nga ana e studentëve për njohuri mbi Trashëgiminë kulturore. Titullarët e lëndëve si **Arkeologji, Etnografi, Komunikim turistik, Antropologji kulturore, Strategji dhe teknika të komunikimit, Ekonomi e aplikuar në turizëm** etj, pohojnë prirjen e studentëve që njohuritë dhe aftësitë e marra në pjesën teorike, t'i zbatojnë në aktivitete konkrete/praktike lidhur me Trashëgiminë materiale, jo materiale dhe natyrore. Nga të dhënat e mbledhura përmes detyrave të kursit në këto lëndë, shumica e tyre i trajtonin temat e fushës së Turizmit, duke u fokusuar në aktivitetin turistik që zhvillohet në vendbanime arkeologjike, historike, zona të tjera të trashëgimisë kulturore, si lagje muze, apo të lidhur me folklorin, zakonet e doket tradicionale, besimet dhe bestytnitë e traditës etj.

Studimi mori në shqyrtim numrin e studentëve të Masterit të komunikimit ndërkulturor e turistik këto katër vite, si dhe numrin e punimeve të tyre.

Pesëmbëdhjetë studentë, minimalisht me nga një punim (detyrë kursi) për secilën nga gjashtë lëndët që preknin trashëgiminë kulturore, si dhe punimet e tyre të diplomës në fushën e komunikimit ndërkulturor.

Sa i përket punimeve të diplomave, ndër vite konstatohet se thuajse 80 % e studentëve parapëlqejnë të trajtojnë, me shumë tema lidhur me zhvillimet e Turizmit në Shqipëri, promovimin e trashëgimisë kulturore të trevave shqiptare për turistët e huaj, sesa tema të përgjithshme që lidhen me fushën e Komunikimit në tërësi. Kjo për arsyet që renditëm pak më lart.

Si detyrat e kursit, edhe diplomat përfundimtare shfaqen në të shumtën e rasteve si punime tërësisht përshkrimore, dhe ku risia qëndron vetëm te përcaktimi i fokusit të studimit apo thellimi modest në të.

Një prirje e tillë e konstatuar përmes analizës së përmbajtjes të temave të diplomës dhe detyrave të kursit, na orienton drejt një hipoteze se thellimi në këtë fushë do të rriste cilësinë e formimit të studentëve dhe do t'i përgjigjej më mirë interesave të tregut të punës. Të dhënat e mbledhura për çështjet si më sipër, sjellin informacione të cilat ndihmojnë për të kuptuar më mirë panoramën e përfshirjes së elementeve të trashëgimisë kulturore në kurrikulat tona. Sigurisht që numri i kufizuar i të dhënave nuk mundëson analizat sasiore të tyre, por megjithatë është i mjaftueshëm

për të arritur në përfundime lidhur me prirjet dhe interesin që fusha e Trashëgimisë kulturore, paraqet për lëndët dhe programet e caktuara. Duke patur në dorë këtë informacion të prodhuar nga analiza e kurrikulave dhe intervistat me studentë e profesorë të lëndëve, kemi mundësi të avancojmë për të nxjerrë konkluzione në lidhje me interesin mbi këtë fushë, si dhe masat që duhen marrë për të materializuar një prani më të madhe të kësaj fushe në programet tona.

Sigurisht një çështje që i ngelet gjykimit tonë profesional është vlerësimi i të dhënave në aspektin sasior, në kuptimin që mungesa e standardeve apo e kurrikulave model e bën të vështirë analizën e kësaj çështjeje. Në këto kushte mënyra e vetme për të shfrytëzuar këtë informacion është të përcaktojmë indikatorë që kuantifikojnë objektivat mësimore të programeve dhe lëndëve tona. Thënë ndryshe, është gjykimi ynë i përbashkët që duhet të vlerësojë se në ç'masë temat e trashëgimisë kulturore duhet të përfshihen në kurrikulat tona dhe sesa i shërbejnë ato formimit të studentëve me objektiv final, krijimin e një ekspertize profesionale në tregun e punës.

Duke u fokusuar te objektivi se në çfarë mase duhet të përfshihen tema apo njohuri mbi trashëgiminë kulturore në kurrikulat tona, kjo kumtesë u bazua në perceptimet e profesorëve dhe studentëve mbi këto lëndë, gjatë intervistave me ta. Këto perceptime mund të na çojnë drejt disa përfundimeve të cilat sigurisht

janë orientuese dhe thjesht ndihmojnë drejt një fokusi më të mirë në lidhje me çështjen.

Konkretisht, ekzistonte një dakordësi në gjykimet e studentëve dhe profesorëve si në vijim:

1. Ka një tendencë të konsoliduar tek studentët për të shkuar drejt temave të trashëgimise kulturore, kjo me sa duket për shkak të afërsisë së tyre me objektin e studimit, si dhe me përfitime praktike nga të nxënit, duke e perceptuar konkretisht veten në rolin e guidës turistike apo mediatorit kulturor.

Në këtë plan mund të thuhet që përzgjedhja e këtyre temave nuk është dhe aq e stimuluar nga interesi shkencor për to, sesa nga fakti që tema të tjera me karakter teorik dhe shkencor mund të mbeten më abstrakte për formimin e tyre aktual, apo edhe më sfiduese. Cilado qoftë arsyeja, tendenca drejt shkencave të aplikuara është e konfirmuar dhe nuk ka përse të mos mbështetet.

2. Profesorët nga ana e tyre, ndihen entuziastë pasi shohin një rritje të interesimit për lëndën dhe një motivim të studentëve, si dhe nuk e gjejnë të vështirë përmirësimin e kurrikulave nga pikëpamja procedurale (në kuptimin që mund të integrojnë lehtësisht temat e kërkuara në kurrikula pa procedura miratimi komplekse).

Kështu, mund të themi se përfshirja e trashëgimisë kulturore në programe mësimore është aktualisht një prioritet i konfirmuar, e kërkuar nga studentët si dhe e

mbështetur nga stafi pedagogjik. Ka një dakordësi për dobinë dhe përfitimet, të cilat shtrihen, nga përforcimi i njohurive gjuhësore në nivel profesional, tek njohja e trashëgimisë kulturore si pjesë e identitetit kombëtar deri tek krijimi i aftësive praktike për t'iu përshtatur më mirë tregut të punës. Kjo është reflektuar me një rritje graduale të pranisë në kurrikula si dhe në punët kërkimore të studentëve. Duke e konsideruar si një dukuri të pohuar, çështja që mund të shtrohet është se si mund të përmirësohet mësimdhënia dhe përfitimet nga të nxënit në këtë fushë.

Në lidhje me këtë objektiv, ky kërkim provoi të bëjë një vlerësim mbi cilësinë e punimeve të studentëve (detyra kursi dhe tema diplome), si rezultante që reflektojnë të gjithë formimin e studentit.

Është e qartë se puna kërkimore e studentëve në përputhjeedhemeobjektivatmësimoretëpërcaktuara, nuk mund të shkojë përtej një punimi përshkrues dhe të dhënat e mbledhura gjatë punimit çojnë në mënyrë logjike në informacione të konsoliduara dhe të përdorshme në përputhje me qëllimin e temës.

Vlerësimi i cilësisë së punës kërkimore të studenteve, përveç koherencës me lëndën mesimore, aspektin gjuhësor apo cilësinë e shkrimit akademik të përdorur, lidhet me vlerësimin e të dhënave të mbledhura, të cilat do të çojnë drejt një informacioni të dobishëm. Në këtë këndvështrim, ia vlen të diskutohet se si mund të rritet cilësia e këtyre të dhënave dhe çfarë

përmirësimesh mund të zbatohen për këtëçështje në procesin e mësimdhënies dhe në kurrikula.

Nga një vlerësim i shpejtë mbi këtë çështje, u vu re se të dhënat e mbledhura nga studentët, shfaqeshin sporadike, jo të strukturuar sipas një logjike teorike të konsoliduar të këtyre elementeve të trashëgimisë kulturore. Punimet duket se dokumentojnë me shumicë një aspekt të caktuar të fushës përkatëse, por linin disi të pacekur aspekte të tjera tepër të rëndësishme: për shembull, fusha e etnografisë është shkencë që merret me studimin e mënyrës së jetesës së popujve, me kulturën e tyre materiale, shoqërore dhe artistike.

Faza e parë e metodologjisë kërkimore që lidhet me mbledhjen e të dhënave shfaq mangësitë e studentëve në përzgjedhjen (nga mungesa e burimeve të sakta bibliografike) dhe seleksionimin e duhur të burimeve dhe të dhënave. Ndërsa, faza vijuese tepër e rëndësishme, ajo e analizës, interpretimit, lidhjes së fakteve/të dhënave paraqet në të shumtën e rasteve rezultate të kufizuara. Edhe pse në aspektin teorik u kushtohet kohë e mjaftueshme dhe vëmendje e veçantë skemave të një kërkimi të mërfilltë apo skemave model, aftësia analizuese në këto lloj punimesh lë për të dëshiruar shumicën e rasteve.

Sigurisht, në këto vite kemi konstatuar edhe punime diplomash orgjinale, ku studentët të motivuar, kanë bërë etnografin dhe folkloristin në

mbledhjen e të dhënave në terren dhe analizën e tyre, si ai i Lola Prengës, studente e vitit të kaluar që ka sjellë një punim të plotë, origjinal e me vlera mbi etnografinë e vendit të saj të lindjes, Mirditës; apo punimi i Anita Duriçit, ku përmes një qasjeje krahasimore mori në analizë vepra e dy piktorëve të shquar Monet-së dhe Vangjush Mihos, si dhe ndikimi ndërthurja e rrymave moderne në veprat e autorit shqiptar.

Të kuptuarit e plotë të kësaj çështje kërkon analizë të thelluar duke u ndalur në çdo rast konkret, çka nuk mund të arrihej përmes kësaj kumtese, por megjithatë disa indikacione u siguruan duke shpjeguar shkaqet e dobësive.

Trajtimi i elementeve të trashëgimisë kulturore të integruara si pjesë e temave në fusha të tjera, paraqet vështirësi që në përgjithësi janë të brendshme për fushat ndërdisiplinore. Ndërkohë që studentët kanë siguruar një formim solid teorik për fushën kryesore të studimit apo lëndës (turizmin në rastin tonë), temat e ndërthurura me to, konkretisht temat e trashëgimisë kulturore, zhvillohen dhe ceken në një rrafsh kryesisht përshkrues dhe informues, pa u investuar në njohuri të avancuara shkencore. Kjo ndodh për arsye objektive të pamundësisë që kurrikulat të mbulojnë në 100% çdo element të fushës të studimit. Në këtë rast, zgjidhje praktike dhe e

realizueshme, do të ishte plotësimi i kuadrit teorik të kategorive specifike të trashëgimisë kulturore, përmes identifikimit të burimeve shkencore dhe përfshirjes të kësaj bibliografie, në kurrikulat e lëndëve, të cilat kanë karakter ndërdisiplinor dhe përfshijnë elemente të trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu, orientimi i studentëve përmes botimeve shkencore në fushën e trashëgimisë kulturore do t'i ndihmonte në procesin e kërkimit dhe analizës së të dhënave duke i fokusuar drejt hipotezave të bazuara shkencërisht dhe prodhimit të një informacioni cilësor. Botime të Akademisë së Shkencave, të Instituteve studimore e kërkimore të cilat dokumentojnë qartë gjetjet e shkencës në fushat specifike, do të ndihmonin në fokusimin e studentëve në tema thelbësore, si dhe në mbledhjen e të dhënave, që pasi të vendosen në një kuadër teorik të strukturuar e konsoliduar, çojnë automatikisht në deduksione dhe përfundime të dobishme.

Gjykojmë se përmirësimi i vazhdueshëm i bibliografive në kurrikulat përkatëse si dhe rritja e bashkëpunimit me Institutet studimore, Departamentin e trashëgimisë kulturore, apo institucione që zotërojnë të dhëna të përpunuara dhe me integritet të pranueshëm, do të rriste cilësinë në formimin e studentëve tanë në fushën e trashëgimisë kulturore.

BIBLIOGRAFI

Plani mësimor i programit të studimit të ciklit të parë: fusha:

Gjuhë frënge; drejtimi: “Gjuhë dhe Komunikim”.

Plani mësimor i programit të studimit të ciklit të dytë

Master i shkencave në “Gjuhë dhe Komunikim
ndërkulturor e turistik” për gjuhën frënge

Kurrikula e vitit të tretë: Gjuhë frënge; cikli i parë i
studimeve: „Gjuhë dhe Komunikim“

Programet e studimit të ciklit të dytë “Gjuhë dhe
Komunikim ndërkulturor e turistik”

Dr. Mikaela MINGA

Etno/muzikologe

Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit

**PRAKTIKAT SHUMËZËRËSHE
TRADICIONALE: DOKUMENTIMI,
PROMOVIMI DHE ROLI I TYRE NË
TURIZMIN KULTUROR.
RASTI I VLLIHËVE TË DRENOVËS**

Këtë shkrim ia kushtoj Aleks Mihallarit, një prej protagonistëve më të veçantë të albumit “Këngë arumune të Drenovës”, i cili ndërroi jetë më 19 janar 2022. Ishte privilegj ta njihja nga afër një artist të tillë, Zë unik i një kulture të kënduari vllahe që e zotëronte mjeshtërisht. Kënga për të nuk ishte manifest festivalesh folklorike (madje këta të fundit, nuk ditën të zbulojnë atë potencial që kishte); kënga ishte pjesë e jetës, i vinte së brendshmi, me një forcë të tillë që edhe kur i mungonin shokët, bëhej vetë shumëzërësh. Këtë interpretim unik të tijin “Di cënd deadi laia lună” patëm fatin ta regjistronim edhe në album në fjalë.

Ljau canticle Leka mes të shumtëve, ashtu si dije ta bëje vetëm ti. Ne këtej do të kujtojmë përmes zërit.

Abstract

Discourses about intangible cultural heritage have been specifically associated to the practices of multipart singing in southeastern Europe from the moment that the multipart singing traditions of south Albania have been proclaimed (2005) and then inscribed (2008) in the UNESCO Representative List of the Intangible Cultural Heritage of Humanity. This expression has come to represent an important “cultural asset” (Minga 2017, 5-17) for scholars, performers and especially cultural workers, something that has its own ramifications in cultural tourism.

In this contribution, I explore the way that this cultural heritage can be valorized and promoted by putting together performers, cultural workers and scholars. My focus is the making of a musical album: *Aromanian Songs from Drenova/Këngë arumune të Drenovës* (Squilibri Editore: 2018) with folk songs, performed by a group of aromanian-vlachs, from Drenova, a small village in Korça's district (southeastern Albania). This project represented a form of valorization of a musical expression, for creating a *product* (the CD) where artistic performance intertwined with documentation and ethnomusicological work; where aesthetic and artistic values come together with cultural, anthropological and historical aspects, for bringing to the audience the traditional sound of Drenova village, open to touristic development programs.

Duke filluar nga vitet 2000 e në vijim ka pasur një interes gjithnjë në rritje ndaj politikave mbi trashëgiminë kulturore, çka padyshim luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit kulturor. Po ashtu, trashëgimia kulturore është kthyer edhe në një disiplinë shkencore me fokus të vetin. Megjithatë, formësimi i këtij roli në mënyrë sa më sistematike e solide ndjek dinamikat e veta që kërkojnë vëmendje të posaçme, aq më tepër kur bie fjala të shprehje konkrete dhe forma me të cilat këto të fundit mund të promovohen, në nivelin qendror, apo lokal. Dhe një nga këto shprehje konkrete mjaft të rëndësishme janë edhe praktikat tradicionale shumëzërëshe të të kënduarit, njohur edhe si polifoni popullore apo iso-polifoni popullore shqiptare, e interpretuar gjerësisht në jugun e Shqipërisë.

Kjo praktikë ka pasur vëmendje të vazhdueshme në kuadrin e folklorit shqiptar gjatë periudhës diktatoriale, duke u përvijuar si një “aset kulturor”, i studiuar sistematikisht nga etnomuzikologjia shqiptare dhe po ashtu i shfaqur në skenë në kuadrin e festivaleve folklorike që promovonin, edhe me një ngarkesë të madhe ideologjike, vlerat e folklorit shqiptar socialist. Veçoritë e këtij aseti erdhën duke u ripërmasuar sërish prej momentit kur Shqipëria ratifikoi konventën e vitit 2003 për trashëgiminë kulturore. Pika kulmore ishte viti 2005 kur ajo u shpall pjesë dhe 3 vjet më vonë u regjistrua në

Listën Përfaqësuese të UNESCO-s për trashëgiminë kulturore shpirtërore, nën emrin Albanian folk isopolyphony/Iso-polifonia folklorike shqiptare. (Për më tepër rreth itinerareve të këtij asemi kulturor shih: Minga 2017, 5-17)

Lidhjet midis kësaj trashëgimie kulturore shpirtërore dhe turizmit kulturor mund të përvijohen në nivele të ndryshme: njëri mund të jetë ai i lidhur me politikat shtetërore; qofshin ato lokale apo qendrore. Për shembull, modeli më përfaqësues i këtyre politikave ka qenë ai i festivalizimit, në një kuadër kombëtar. Për këtë është Festivali i Iso-Polifonisë, i cili zhvillohet çdo dy vjet nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale. Një tjetër mund të jetë si pjesë e leximeve dhe e një shqyrtimi më të thelluar etnomuzikologjik edhe etnografik, sikundër ka ndodhur me kontribute të ndryshme shkencore (vëllimi *European Voices: Multipart singing in the Balkans and the Mediterranean* i përgatitur nga Ardian Ahmedaja dhe Gerlinde Haid, 2008; *Performing nostalgia: Migration culture and creativity in South Albania* punë kërkimore nga Eckehard Pistrick, 2015; *A journey of the Vocal Iso(n)* nga Eno Koço, 2015). Vlen të përmendet përveç botimeve edhe një grupit studimor i ngritur pranë ICTM (International Council of Traditional Music-Këshilli ndërkombëtar i muzikës tradicionale) mbi të kënduarin shumëzërësh i quajtur ICTM study group on multipart singing i cili

kohë pas kohe jep kontributet e veta (Veçoj sidomos: Macchiarella 2010; Ahmedaja 2013).

Megjithatë, këtu do të doja të prezantoja një perspektivë disi më subjektive, e personale, që ka lindur jo si punë kërkimore, por si një projekt muzikor artistik rreth të cilit lindi nevoja e një hulumtimi bashkëshoqërues etnomuzikologjik. I gjithë procesi u finalizua në formën e një albumi muzikor, në CD - i cili u publikua në vitin 2018 nga Squilibri Editore, me qendër në Romë¹.

AROMANIAN SONGS FROM DRENOVA/
KËNGË ARUMUNE TË DRENOVËS
edited by Josif Minga and Mikaela Minga



squilibri

Fig. 1

¹ Shih: <https://www.squilibri.it/catalogo/cd-e-dvd/josif-e-mikaela-minga-a-cura-di-aromanian-song-from-drenova.html> (konsultuar për herë të fundit më 15 dhjetor 2022).

Projekti, siç vërehet edhe nga fotoja e kopertinës, titullohet *Aromanian songs from Drenova/Këngë arumune të Drenovës* dhe, në një nivel makrobën bashkë diskursin mbi trashëgiminë kulturore shpirtërore në Shqipëri, kërkimin etnomuzikologjik në dokumentimin dhe promovimin e praktikave konkrete muzikore dhe format e divulgimit të tij, si dhe rolin e pakicave kombëtare - në këtë rast minoritetit arumun - në këtë hartë trashëgimie. Megjithatë po flasim për trashëgimi shpirtërore ky projekt nxjerr në pah edhe një lloj paradakosi të lidhur me materialitetin, po të kemi parasysh që mediumi përmes të cilit realizohet i gjithë procesi, në këtë rast, është diçka materiale, e përfaqësuar përmes CD-së. Në një nivel më mikro, ai përpiket të eksplorojë lidhjen delikate midis artefaktit muzikor dhe përvojës njerëzore; midis idesë së trashëgimisë si diçka që duhet ruajtur, dokumentuar dhe performancës artistike si një entitet i gjallë, si një përvojë e drejtpërdrejtë. Së fundi, ai përpiket të eksplorojë lidhjen midis një praktike muzikore e cila përfshihet në gjeografinë kulturore shqiptare, por që i përket një minoriteti, atij vllaho-arumun të Drenovës, një fshat në afërsi të Korçës me një histori të pasur kulturore, i cili ndër të tjera u shpall edhe pjesë e 100 fshatrave turistike, në projektin e qeverisë shqiptare të fillim vitit 2018².

² Shih për këtë: <https://bujqesia.gov.al/programi-i-integruar-per-zhvillimin-rural-programi-i-100-fshatrave-2/> si dhe listën: <https://bujqesia.gov.al/>

Minoriteti vllaho-arumun ka qenë historikisht i lënë mënjanë gjatë shekullit të XX dhe deri diku në përpjekje për t'u asimiluar, ndërkohë që ka pasur dhe akoma ka një hapësirë vitale në hartën e gjerë të praktikave muzikore shumëzërëshe në Shqipëri, madje do shtoja në përgjithësi në Europën juglindore.

Më konkretisht, në ditët e para të janarit të vitit 2016, u ftova për të dëgjuar një grup këngëtarësh vllahë nga Drenova e Korçës, të cilët kishin dëshirë të bënin një album me këngët që zakonisht i interpretonin së bashku. Ata ishin: Aleks Mihallari, Spiro Gramozi, Spiro Bello dhe Thanas Tona. Fillimisht i ishin drejtuar kompozitorit Josif Minga, i cili ka një përvojë të gjerë e të gjatë me traditat muzikore të gjithë zonës juglindore për t'i udhëhequr në këtë ide. Grupi interpretonte atë që njihet si stili Tosk i të kënduarit, i ndarë në 3 pjesë, zëri i parë, i cili merr melodinë dhe që prej tyre emërtohej si *ljau tini*, *ljau cāntācli*, ndërsa në shqip *marrësi*. Zëri i dytë që ndërvepron me të parin, *su tsān mini*, që në shqip do të thotë ai që e pret, e mban (prerësi); pra, ai që përfshihet muzikalisht nga *marrësi*. Në fund, kemi një pedal të pandërprerë isoje, mbi zanoren “e” të hapur.

Përshtypja më mbresëlënëse e kësaj përvoje të parë dëgjimore me ta ishin aftësitë e jashtëzakonshme vokale të këngëtarëve dhe mënyra mjeshtërore

se si ata e zotëronin repertorin. Dy prej tyre ishin interpretues të njohur të zonës: Spiro Gramozi dhe Aleks Mihallari. Ndër të tjera, ata kishin marrë pjesë edhe në festivalet folklorike. Por sidomos ky i dyti, i aftë të këndonte si rolin e marrësit, ashtu edhe atë të prerësit të këngës.

Ndërkaq, disa aspekte kërkonin vëmendje dhe thellim, çka erdhi përmes zhvillimit të një sërë bisedash me ta jo vetëm rreth mënyrës si e praktikonin këngën por edhe rreth jetës të tyre. Këta protagonist e identifikojnë veten si *armãn* or *fërshãrot*. Deri në fillim të vitevet '60, ata ishin vllahë nomadë dhe jetonin me tranzumanca; verës në malet e Korçës, ndërsa dimrit në klimën e butë të Konispolit. Familjet e tyre u vendosën në Drenovë në fillim të viteve '60-të, si rrjedhojë e masave që regjimi mori për të ndaluar këtë lloj mënyre jetese, tepër dyshuese në zonat kufitare, por edhe e papërshtatshme me normëzimin shtetëror të ekonomisë blegtorale. Në këtë mënyrë, ata filluan një jetë të tjetër: nga barinj shtegëtarë u kthyen në force punëtore të ndërmarrjeve shtetërore të Drenovës, që në atë kohë numëronte disa nga më të rëndësishmet në zonën e Korçës, qoftë sa i takon kuadrit bujqësor të kooperativës, ashtu edhe atij industrial, që evidentohet përmes minierave të zonës.

Regjimi diktatorial nuk i njohu si minoritet (1945-1991). Ata kishin të drejtën të zgjidhnin ku të jetonin e të stabilizoheshin, por jo të përfaqësoheshin me

kulturën e tyre. Të gjitha këto elemente që më nxitën për ta konceptuar këtë projekt jo si një proces të thjeshtë përgatitjeje të një albumi muzikor, por, si e nënvizova qysh në fillim, si një formë valorizimi të shprehjes muzikore, ku performanca artistike kombinohej me punë dokumentimi etnomuzikologjik; një punë ku vlerat estetike bëhen bashkë me ato kulturore, antropologjike dhe historike.

Vllehët nuk u lejuan të këndonin në gjuhën e tyre. Në disa raste, ndodhi që tekste të këngëve të përkthesheshin në shqip dhe të interpretoheshin në skenë. Për shembull, “Ç’më zu vesa në lëndinë”, si variant i “Bună-ți oara, picurare”.³ Pavarësisht këtij kushti asimilues, një formë latente, e fshehur dhe e ruajtur si praktikë që vijoi të gjallonte mes tyre duke u interpretuar në mbrëmje e festa intime dhe sidomos në ritualin e dasmës, me pak fjalë jashtë gjithë atij realiteti skenik të programuar, në të cilin u vendosën praktikrat tradicionale gjatë komunizmit.

Rënia e regjimit në fillim të viteve ‘90, i gjallëroi kontaktet e këtij minoriteti me rrjete kulturore më të gjera të kulturës arumune, sidomos ato në Greqi dhe

³ Dy variantet mund të konsultohen në youtube: Çmë zu vesa në lëndinë. Interpretuar nga Ferzilet Malelli dhe Lindita Ngjela në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës – 1988 (Ansambli “Skënderbeu”). https://www.youtube.com/watch?v=rt7_rakSdPI . Konsultuar për herë të fundit më 14 dhjetor 2022.

Bună-ți oara, picurare / Bună-ți seara, păcurare. Interpretuar nga Oca Fote dhe Olimpia Dima. <https://www.youtube.com/watch?v=8RGT-e5PcnQ> Konsultuar për herë të fundit më 14 dhjetor 2022.

Rumani. Megjithatë, fillimisht arumunët nuk u njohën si pakicë kombëtare në Shqipëri, por vetëm si grup kulturor. Kjo nuk i pengoi që të krijonin rrjetin e tyre, për të bashkuar të gjitha grupet që jetonin në Shqipëri. Pavarësisht përpjekjeve, shoqatat nuk lëvizën në një rrugë të përbashkët dhe shumë shpejt rigjallëruan një ndarje të hershme mes komunitetit, nga fillimi i shekullit të 20-të, ndarje mes atyre që mbështesnin prejardhjen rumune dhe atyre që zgjidhnin atë greke. Nëse diktatura pengoi mënyrat e vetorganizimit, post-diktatura i polarizoi ato; nëse regjimi i Hoxhës nxiti një situatë asimilim/homogjenizim dhe ruajtje të fshehur, periudha post-dikatoriale, me realitetet shumëplanëshe dhe jo pak kontradiktore, shtroi problematika komplekse në lidhje me ruajtjen dhe praktikën e muzikës së tyre, qoftë në nivelin komunitar, ashtu edhe si performancë skenike. Në fillim të vitit 2016, ndërsa po ravijëzohej ideja e këtij albumi, Spiro Gramozi dhe Spiro Bello sapo ishin kthyer në Drenovë, pas rreth 25 vjet emigrimi në Greqi pas rënies së regjimit dhe vështirësive ekonomike. Ideja për t'u bërë bashkë me sa duket e pati zanafillën te dëshira e secilit për të kënduar jetën dhe historitë e tyre; duke rigjallëruar atë praktikë që kish qenë e zakonshme për ta deri në fillim të viteve '90-të. Këtë e bëjnë me vetëdijen e të qenit brezi i fundit që interpreton këngën polifonike (fëmijët e tyre apo brezat më të rinj të këtij komuniteti nuk kanë interes

për ruajtjen e kësaj tradite dhe janë përgjithësisht të tërhequr nga stile muzikore bashkëkohore). Me një lloj fanatizmi, ata distancohen gjithashtu nga stile të tjera të kënduari të arumunëve në krahina të tjera, si dhe nga trajta më hibride aranzhimesh elektronike.

Në vitin 2017, shteti shqiptar i njohu arumunët si pakicë kombëtare (Ligji nr. 96/2017). Kjo ndodhi gjatë kohës që po punonim me regjistrimin e këtij albumi, rastësi që përforcoi akoma më shumë hapësirën që kanë brenda kësaj muzike aspektet kulturore dhe historike. Mirëpo, megjithë ndryshime e vazhdueshme, politikat kulturore në mbështetje të muzikës së këtij minoriteti ishin ende të pa përvijuara si duhet.

Një rast mjaft të qartë pata mundësi ta ndiqja vetë, personalisht, gjatë Festivalit të Iso-polifonisë në Vlorë, në nëntor, të vitit 2017, organizuar çdo dy vjet nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale (QKVT). Grupi në fjalë mori pjesë në këtë festival dhe u vlerësua për cilësitë vokale, por u skualifikua nga konkurrimi vetëm se nuk kishte kostume popullore. Si studiuese, nuk mund të mos e konsideroja këtë situatë si një “etnografi terreni” e cila nxirrte në pah miopinë që ky organizim festivalor tregonte në raport me kushtet bashkëkohore në të cilat gjallojnë praktikat tradicionale.

Realizimi i kostumeve tradicionale përpara viteve '90-të, kohë kur festivalet folklorike ishin kryefjala

e ideologjizimit dhe spektakolarizimit të folklorit, bëhej në mënyrë të posaçme nga shtëpitë dhe pallatet e kulturës. Ai ishte pjesë i një ingranazhi i cili ka degraduar në mënyrë të pakthyeshme prej viteve '90-të e në vijim. Pikërisht gjatë kësaj periudhe, ky fond kostumesh i cili ripërtërihej çdo pesë vjet në qarqet e vendit ose u vodh, ose u plaçkit. Në kushtet e sotme kur institucionet kulturore vendore nuk e mundësojnë dot një gjë të tillë financiarisht, do të duhej të kishte një rishikim të vazhdueshëm të atyre që njihen si "kritere artistike" të zhvillimit të festivalit për të stimuluar praktikën e gjallë dhe për të mos ngelur peng i kufizimeve, por për ta konceptuar festivalin si një hapësirë takimi, njohjeje, diskutimi mbi repertoret mes grupeve por edhe mes publikut pjesëmarrës. Në këtë kuadër, do të mjaftonte thjesht konteksti historik e politik i këtij minoriteti për të kuptuar që mungesa apo prania e kostumeve tradicionale, nuk do të duhej të ishin kufizuese ndaj artit që ata trashëguan në kushte asimilimi dhe mosnjohjeje.

Për më tepër, festivali në vetvete përfaqëson një arenë debutuese për praktikën vokale ndaj do të ishte e udhës që aspektet vizuale të konsideroheshin si aksesore mbështetës dhe jo si një kriter skualifikues në një kohë kur askush tanimë nuk interpreton me kostume tradicionale dhe ky mbetet në vetvete një aspekt artificial performativiteti.

Arsyeja kryesore pse këta burra ishin bërë bashkë në këngë ishte një nevojë e përbashkët për të kënduar rreth vetes, rreth historive të tyre, duke qenë njëkohësisht të ndërgjegjshëm që ata përfaqësonin brezin e fundit që interpretonte këtë këngë shumëzërëshe. Emigracioni, lëvizjet e popullsisë, por edhe formatet e reja të muzikëbërjes, stilet e reja muzikore kishin pasur edhe ata rolin e tyre në bjerren e kësaj praktike. Një tregues për këtë ishte edhe pamundësia për të gjetur interpretues të isos mes tyre, çka na detyroi që të merrnim këngëtarë të tjerë si mbështetës dhe mbushës së saj.

Nga ana tjetër, drejtimi artistik i Josif Mingës, njohës i thellë dhe për një periudhë të gjatë i praktikave tradicionale të zonës së Korçës, ishte thelbësor për të arritur ekuilibrin e duhur mes vlerave estetike dhe atyre kulturore. Duke marrë parasysh miqësinë e hershme me disa prej këngëtarëve, Josif Minga u përpoq që të përvijonte një marrëdhënie bashkëpunuese, duke njohur dhe ndarë qëllimet e objektivat e përbashkëta të projektit. Një partneritet i tillë çoi në zgjidhje të caktuara, të cilat do t'i shqyrtojmë konkretisht në vijim. Ndërsa merrte formë gradualisht, projekti i këtij albumi pasqyroi gjithashtu një formë veteksplorimi të kulturës së tyre muzikore; një kulturë joshja dhe fuqia tërheqëse e së cilës shkon përtej diskutimeve dhe kontradikateve të origjinës, apo edhe kurtheve politike antiproduktive. Kjo muzikë është njëherazi bashkëkohore dhe historike; ajo arrin të përmbajë

dhe të transmetojë rrëfime të reja po aq sa dhe histori të vjetra të arumunëve drenovarë.

Regjistrimi u realizua në gusht të 2017, në një qoshe të sajuar në një ambient ku ata mbledheshin zakonisht. Në gjysëm rreth me mikrofonim të përshtatshëm për atë që Thomas Turino e quan “regjistrim me cilësi të lartë”/ “high fidelity recording” (Turino 2008) (Fig. 2). Ti vendosje këta këngëtarë në studio regjistrimi do të ishte një lloj denatyrimi i praktikës, ndaj edhe regjistrimit “high fidelity”, gjithmonë sipas konceptualizimit që i bën Thomas Turino i vendosëm formatin e performancës me pjesëmarrje (participative performance). Në përzgjedhjen e numrave u përfshinë 16 këngë dhe një valle instrumentale, interpretuar nga një grup sazes. 15 këngë janë në gjuhën vllahe, ndërsa një këngë është në shqip. Materiali në fjalë është interpretuar prej tyre shpesh dhe ka qenë dëshira e tyre për ta përfshirë në album.



Fig. 2. Çaste gjatë regjistrimit

Publikimi i këtij albumi u bë i mundur nga Shtëpia botuese *Squilibri* në Itali, dhe këtu më duhet të vërej se Shqipëria ende nuk i ka mundësitë e publikimit të materialeve të këtij standardi, çka pengon gjerësisht kryerjen e operacioneve të këtij tipi në mënyrë profesionale, sikundër nxjerr në pah edhe interesin specifik që një shtëpi botuese jo shqiptare tregon ndaj trashëgimisë kulturore të një vendi dhe operacioneve të tilla specifike artistike dhe dokumentare e studimore.⁴

Në përmbyllje të këtij kontributi, ajo që do të doja të theksoja është se ky projekt nuk synon të jetë një formë që duhet marrë si shembull për mënyrat si duhet të përballemi me trashëgiminë kulturore dhe praktikat e gjalla, dëshiron të nxisë reflektimin rreth *formave të negociimit* midis asaj çka është trashëgimia dhe praktika e gjallë dhe si këto integrohen brenda procesesh të ndryshme valorizimi, ngjitjeje në skenë, kërkimi etnomuzikologjik, turizmi kulturor. Nuk mjaftojnë vetëm formatet festivalore, por është i nevojshëm një komunikimi dhe bashkëpunim i vazhdueshëm mes palëve (artistë interpretues, operatorë kulturorë, studiues), për të maksimalizuar potencialin specifik të shprehjeve tradicionale dhe

4 Një punë tjetër e ngjashme e realizuar po nga Squilibri ka qenë ajo mbi këngën korçare dhe artisten Spanja Pipa. <https://www.squilibri.it/catalogo/atm-archivio-tradizioni-musicali/mikaela-minga-nicola-scaldaferri-spanja-pipa.html> Konsultuar për herë të fundit më 14 dhjetor 2022)

për ta përcjellë në gjithë përmasën e tyre estetike dhe kulturore për një audiencë e publik sa më të gjerë e të larmishëm.

BIBLIOGRAFI

- Ahmedaja, Ardian. 2013. "Local and Global Understandings of Creativities: Multipart Music Making and the Construction of Ideas, Contexts, and Contents". Cambridge Scholar Publishing
- Ahmedaja Ardian dhe Gerlinde Haid (përg). 2008. "European Voices: Multipart singing in the Balkans and the Mediterranean". Wien: Böhlau
- Pistrick Eckehard. 2015. "Performing nostalgia: Migration culture and creativity in South Albania". Farnham, Burlington: Ashgate,
- Koço Eno. 2015. A journey of the Vocal Iso(n). Newcastle upon Tyne: Cambridge Scholars Publishing.
- Turino Thomas. "Music as social life. The politics of participation". Chicago: The University of Chicago Press
- Minga Mikaela. 2017. "Itineraret e një asemi kulturor". *Shejzat* 3-4: 5-17

Dr. Arba Baxhaku
Bashkia e Tiranës
Fakulteti i Arkitekturës
Universiteti Politeknik i Tiranës

**TRASHËGIMIA E TIRANËS
NËN RITMET E QYTETIT
BASHKËKOHOR:
RASTI I SHTËPISË STUDIO
KADARE**

Abstract

The architectural project of the 'House Studio Kadare' and the curation of the exhibition space are the work of the architect Elisabetta Terragni, with the support of a team of local researchers, as well as the group of architects of the Municipality of Tirana. The challenge of this project was to create a space where literature could stand out, an exhibition space which paradoxically opened to visitors within the living environment, which arise primarily as a closed and intimate space. This is where the key problem arose: is it possible to create an exhibition space inside an ordinary apartment able to attract visitors from outside? The answer must be sought

in the character of Kadare's literature, which, as he puts it, is 'the normal literature of a writer who lived in an abnormal country'.

The 'House Studio Kadare' represents a 'lieu de m  moire' that crosses the priceless treasures of the country's cultural heritage: the apartment as a monument to the collective memory of the city and literature. For this reason, this space also refuses to be turned into a tomb or mausoleum of the celebration of Kadare, all appearing as an architectural narrative of literature. A narrative that takes place in the rooms in which his literature was created, and which takes shape through the order of publications, translations, manuscripts, references, urban landscapes of inspiration, objects and archival materials. The first glance at Ismail Kadare's apartment penetrates through an embrasure into the wall separating the entrance stairs from the writer's studio. A space full of mystery unfolds in which the visitor begins to experience the secrets of the writer's creativity from the outside. The entrance to the 'Studio House Kadare' repeats the former itinerary of the apartment, with the first stop in the living room, in which the former atmosphere of living is preserved. Materials from the State Archive, the Construction Archive, the Central State Film Archive, the Petrit Kumi Archive and the National Library constitute the facts and data exposed, on which the entire museum project was built. The itinerary concludes with a study room, located in the former bedroom of the couple, now transformed

into a space dedicated to the continuation of the life of the apartment through deepening in the study of the work of the former resident of these walls.

Keywords: *architecture, memory, literature, archive, Kadare, MaksVelo, museum*

‘Shtëpia Studio Kadare’ refuzon të quhet ‘muze’, paçka se apartamenti ku jetoi shkrimtari i madh ndërmjet viteve 1974-1990 tashmë është pronë publike, e hapur për vizitorët e lexuesit e Tiranës Brenda një orari zyrtar. Ajo përfaqëson një *‘lieu de mémoire’* të mirëfilltë që kryqëzon pasuri të paçmuara të trashëgimisë kulturore të vendit: apartamentin si monument të kujtesës kolektive të qytetit dhe letërsisë. Për këtë arsye, kjo hapësirë refuzon po ashtu të shndërrohet në varr apo në mauzole të kremtimit të figurës së Kadaresë, gjithë duke u shfaqur si rrëfim arkitekturor i letërsisë. Rrëfim ky që zhvillohet pikërisht në odat në të cilat u mbars kjo letërsi dhe nis e merr formë përmes renditjes së botimeve, përkthimeve, dorëshkrimeve, referencave, peizazheve urbane të frymëzimit, objekteve e materialeve arkivore.

Projekti arkitektonik i ‘Shtëpisë Studio Kadare’ dhe kurimi i hapësirës së ekspozimit mbajnë firmën e arkitektes Elisabetta Terragni, me mbështetjen e një ekipi studiuesish vendas, si dhe të grupit të arkitektëve të Bashkisë së Tiranës. Sfida e këtij projekti qëndronte

në krijimin e një hapësire ku të dilte në pah letërsia, një hapësire ekspozimi e cila paradoksalisht të çelej për vizitorët brenda mjediseve të banimit, të cilat lindin parimisht si ambiente të mbyllura, intime. Prej nga lind problemi kyç: A është e mundur të krijohet brenda një apartamenti të zakonshëm një hapësirë ekspozimi që të jetë në gjendje të joshë vizitorë nga jashtë?

Përgjigjja duhet kërkuar te vetë karakteri i letërsisë Kadarese, e cila, siç shprehet ai vetë, është *'letërsia normale e një shkrimtari që jetoi në një vend anormal'*.

E njëjta kontradiktë mvësh dhe karakterin e apartamentit të tij, duke qenë se shfaqej si hapësirë jashtë-serie në një vend që kish filluar të ngjante gjithnjë e më uniform për nga dukja. Letra murale, moketi i dhomës së ndenjies, pllakat e gramafonit, biblioteka e bardhë modulare e sjellë nga jashtë e sidomos oxhaku i fshehtë i realizuar me porosi, janë të gjitha objektet jashtë serisë së standardizimit të kohës të cilat dëshmojnë materialisht përpjekjen e Kadarese për t'i shpëtuar normës. Një norme të pazakontë që i përkiste një vendi 'anormal'. Të krijohet përshtypja se kureshtja që ngjallte në qytet apartamenti, me objektet e tij të veçanta, sikur i bashkëngjitej tisis të mistershëm që shoqëronte vetë figurën e Kadarese, shkrimtarit që prodhonte në Shqipërinë e izoluar një letërsi të jashtëzakonshme.

Kështu, tej të qenit ‘studioja’ e autorit në vitet e tij më prodhimtare, apartamenti shërben për të përshfaqur konkretisht antikonformizmin e letërsisë së tij. Për këto arsye, ‘Shtëpia Studio Kadare’ projektohet si skenë arkitektonike mbi të cilën vihet në pah vepra.



Në të njëjtën vazhdë, materialet e ekspozuara i shpalosen pa komente leximit objektiv të vizitorit. Ato rreken t’i mposhtin kufijtë gjeografikë dhe ta vendosin letërsinë kadareane në dialog të vazhdueshëm me kontekstin botëror i cili u vjen natyrshëm e nga i cili Shqipëria u shkëput me përdhunë. Këtij synimi i jep dorë konceptimi i artit letrar, me karakterin e tij universal që i shpërfill kufijtë tokësorë e gjuhësorë: *‘letërsia, si pasuria shpirtërore më e bujshme e planetit tonë, ka dy tipare themelore: është universale dhe është e*

përjetshme. (...) Asnjë shkrimtar nuk e krijon letërsinë për veten e vet. Aq më pak asnjë popull. Qysh në ditën e parë të saj, ajo krijohet për të gjithë. Anglia edhe të dojë ta mbajë për vete Shekspirin e saj, nuk e ka në dorë. Ai na përket të gjithëve. Nuk ka ndonjë hartë popujsh ku letërsia mund të prodhohet, e një tjetër hartë, që kjo është e pamundur.¹

Një tjetër metaforë të karakterit jashtë-norme të letërsisë kadareane gjatë regjimit e mbart godina ku ndodhet apartamenti. ‘Godina me dyqane në rrugën Bajram Curri’ e arkitektit Maks Velo, pagëzuar në kujtesën qytetëse me emrin ‘pallati me kuba’, shtrihet përgjatë rrugës së Dibrës, njëres prej rrugëve më të vjetra të Tiranës. Bashkë me rrugët që mbërrijnë nga viset e tjera të Shqipërisë e që, sikundër ajo, mbajnë mbi shpinë emrin e qytetit të origjinës– rruga e Durrësit, rruga e Kavajës e rruga e Elbasanit – ato takohen e gërshetohen në Pazarin e dikurshëm, duke gjeneruar kështu qytetin.

Në këtë kontekst, të vendosur në zemër të qytetit të vjetër, i cili kish mbetur ende i paprekur nga shndërrimet monumentale të Mbretërisë e bashkimit me Italinë fashiste, a nga rregulli i lagjeve-tip moderne- të viteve të para të regjimit, në vitet ‘70 lartohet ndërtesa e banimit më atipike e Shqipërisë socialiste. Në një dëshmi fotografike bardhezi të kohës, të shkrepur nga fotografi Petrit Kumi, spikat

¹Nga një intervistë e Ismail Kadaresë dhënë për ‘Die Welt’, sjellë në shqip në gazetën ‘Shekulli’, datë 25.07.2017

TRASHËGIMIA E TIRANËS NËN RITMET E QYTETIT BASHKËKOHOR:
RASTI I SHITËPISË STUDIO KADARE



një vëllim i pastër, një prizëm drejtkëndor i bardhë, ritmin e rregullt të fasadës të së cilit e shqetësojnë vetëm dritëhijet e zgavrimeve të lozhave. Lojë kjo e zhvilluar mes plotësisë e zbrazëtirës sipas një rregulli të ri, i cili thyen njëtrajtësinë me parime funksionaliste të fasadave të tjera të godinave të banimit.

Kësisoj, në mes të indit urban historik të qytetit, në lagjen më tradicionale të Tiranës, vendoset një ndërtesë e jashtëzakonshme, thuajse si manifesti gjuhës së re formale që përshkonte vendin tejendane. Njësoj të jashtëzakonshëm u zgjodhën dhe banorët e ngehinës, ndër të cilët autorët Ismail Kadare e Dritëro Agolli, kompozitori Feim Ibrahimini e këngëtarja Zeliha Sina, me fatet përkatëse të lidhura pashmangshmërisht me arkitekturën që banuan.



Planimetria gjatësore e godinës së projektuar nga Maks Velo përbëhet nga katër apartamente për kat, të ndara në dy hyrje për secilën shkallë. Përjashtimi i vetëm janë apartamentet e shkrimtarëve Ismail Kadare e Dritëro. Agolli, të cilëve u është dyfishuar hapësira e banimit nëpërmjet bashkimit të apartamenteve qendrore të katit të tretë e të katërt.

Vështrimi i parë në apartamentin e Ismail Kadaresë depërton përmes frëngjisë së hapur në murin që ndan shkallët hyrëse nga studioja e shkrimtarit. Një zgavrim në lartësinë e syrit lejon depërtimin e menjëhershëm në kthinën më të fshehtë të shtëpisë, dhomën e shkrimit. Shpaloset përpara syve një hapësirë e veshur me gjithë misterin që shoqëron vetë figuren e Kadaresë, në të cilën vizitori nis t'i përjetojë kalimthi, që nga jashtë të fshehtat e krijimtarisë së tij.

Tiparet e saj kyçe janë biblioteka me raftet e librave të huaj, skrivania me makinën e shkrimit dhe oxhaku i fshehtë pranë te cilit ulej të shkruante, sipas ritualit të përditshëm.

Hyrja në 'Shtëpinë Studio' përsërit itinerarin e dikurshëm të apartamentit, me ndalesën e parë në sallon. Ruhet aty atmosfera e dikurshme e jetesës, me bibliotekën prodhim të Kombinatit të drurit 'Misto Mame', me librat në shqip e revistat letrare, televizorin, orenditë e tjera, mobiljet dhe moketin e ngrohtë ngjyrë qumështi. Muret janë veshur me letër murale, të ngjashme me origjinalen, mbi të cilën riprodhohet aparati grafik me kaskadë botimeve të autorit ndër vite. Në hapje të ambientit muzeal shpaloset diagrama me titujt e botimeve në shqip që nisin që nga viti i largët 1954 e deri në ditët e sotme, duke përmbledhur e paraqitur grafikisht një mori të dhënash bibliografike për Kadarenë. Të njëjtat të dhëna, shkrime, shifra e diagrama tashmë përbëjnë dekorin e shtëpisë. Fragmentet e marra nga shkrimet e Kadaresë shndërrohen në ornament të arkitekturës së shtëpisë. Përtej kanateve të bibliotekës së vjetër, si në skenë teatri, fshihen gjithashtu edhe referencat e shkrimtarit, sendet e rradhitura që kujtojnë qytetet e veprës së shkrimtarit: Gjirokastrën e fëmijërisë, Moskën e formimit letrar e Parisin, vitrinën e famës së tij ndërkombëtare. Ndër raftet e referencave reshtohen dhe frymëzimet që vijnë nga Lashtësia,

mitet e tragjeditë, si dhe dashuria me poezinë e Lasgushit përmes botimeve të hershme të 'Yllit të zemrës' dhe 'Valles së yjeve'.



Dy odat e jetesës së përbashkët ndahen me anë të një vetratë me skelet druri, e cila, përtej dritës që lejon të depërtojë në sallon nga jugu në veri, përbën filtrin e parë drejt studios. Vetrata është pjesë e modifikimit të planimetrisë së kërkuar prej Kadaresë: përmes krahasimit me planimetrinë e projektit fillestar bie në sy mbyllja e derës së studios dhe zhvendosja e hyrjes së saj nëpërmjet dhomës jugore të sallonit. Me grafikën e hartës kadareane të Tiranës shtypur mbi vetratë dhe ekspozitën fotografike të qytetit gjatë viteve '70 nëpër mure, kjo dhomë mirëpret një tribut të mirëfilltë ndaj qytetit dhe shndërrohet në zemrën e 'Shtëpisë Studio'.

TRASHËGIMIA E TIRANËS NËN RITMET E QYTETIT BASHKËKOHOR:
RASTI I SHTËPISË STUDIO KADARE



Itinerari i parë mbaron me studion e shkrimtarit, e cila është e vetmja hapësirë e shtëpisë që trajtohet me ftohtësi muzeale dhe në të cilën shmanget mundësia e ndërveprimit me objektet e ekspozuara, sikundër në dhomat pararendëse. Vizitori detyrohet ta shikojë gjithmonë studion nga një distancë e caktuar, fillimisht përmes frëngjisë së hapur në krye të itinerarit muzeal dhe më pas duke mos u lejuar të kapërcejë sinorin e mbishkrimit ‘please, do not go beyond this line’ në parket. Ngjan sikur aty hiqet kufiri mes Kadaresë e të tjerëve, kufi që rreket të ruajë ende qashtërsinë e ‘tempullit’ e krijimtarisë së tij, të amshuar prej vlerës universale e humanitetit të veprës së tij të jashtëzakonshme. Matanë kufindarëses së lutjes anglisht shtrihet perimetri brenda të cilit u mbars letërsia ‘normale’ e një vendi ‘anormal’.

Projekti i 'Shtëpisë Studio' ruan ndarjen e vjetër të apartamentit në dy pjesë. Muri ndarës i dy apartamenteve të projektit fillestar shënjon dhe ndarjen mes pjesës së restauruar si në origjinal të hapësirave të jetesës e asaj që i kushtohet ekspozimit, studimit dhe analizimit të veprës së Kadaresë, të cilat janë shndërruar tërësisht. Kjo e fundit përbëhet nga kthinat intime të familjes, si kuzhina e dikurshme, banjoja dhe dy dhomat e gjumit.

Prania e bashkëshortes Helenë është gjithashtu e dukshme gjatë gjithë itinerarit e del në pah herë përmes rrëfimeve të saj për jetesën e familjes në apartament dhe herë nëpër fotografitë e jetës së përditshme, librat e shënimit. Tenton të spikasë ndër to jo vetëm roli i saj i çmuar në krijimtarinë letrare të të shoqit, por edhe figura e mëvetshme prej autoreje.

Për të theksuar edhe sa më sipër, është zgjedhur të shfaqen në dhomën e filmit përshtatjet kinematografike të letërsisë së dy banorëve të shtëpisë, Helenës dhe Ismailit, përkatësisht me filmat 'Nusja dhe shtetrrethimi' e 'Ballë për ballë'. Në vijim të tributit që i ngihet në këtë shtëpi Tiranës kadareane, kjo hapësirë shërben gjithashtu dhe si sfond i një kolazhi filmik që paraqet atmosferën e qytetit gjatë viteve '70 e '80.

Dhoma tjetër i kushtohet përkthimit, çelësit që i lejoi të kapërcente tej Shqipërisë së izoluar e të mbërrinte famën ndërkombëtare. Aparati grafik i

mureve të kësaj dhome zbërthen nëpërmjet grafikësh e diagramash të dhënat e botimeve të shumta të Kadaresë në gjuhë të huaj, ndërkohë që në mes të dhomës, sikur të ishin skedarë të ndonjë biblioteke, janë renditur qindra versionet e librit të tij më të përkthyer, ‘Gjeneralit të ushtrisë së vdekur’. ‘Fytyrën’ e dhomës së përkthimit e përbën pa dyshim portreti i Marcello Mastroianni-t në rolin e gjeneralit, marrë nga përshtatja filmike italo-franceze e veprës në vitin 1982. Edhe personazhit të Gjeneralit, njëlloj si veprës së shumëpërkthyer, iu desh të merrte trajtat e një prej aktorëve më të njohur të kohës për të mposhtur kufijtë e Shqipërisë socialiste.



Materialet nga Arkivi i Shtetit, Arkivi i Ndërtimit, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Arkivi Petrit Kumi dhe Biblioteka Kombëtare përbëjnë faktet dhe të dhënat mbi të cilën u ngrit i gjithë projekti muzeal. Të

shpërndara nëpër shtëpi dhe të hapura për qasje nga kushdo, gjenden albumet që përmbledhin kërkimin arkivor që ndihmoi kuratorët në leximin e figurës së Kadaresë, si dhe kontekstit, historisë, prodhimit e arkitekturës së kohës kur ai jetoi në këtë apartament.

Itinerari përmbillet me dhomën e studimit, dikur dhomë gjumi e çiftit, e tani hapësirë që i kushtohet vijimësisë së jetës së apartamentit përmes thellimit në studimin e veprës së banorit të dikurshëm të këtyre mureve.

BIBLIOGRAFI:

- Calvino, I., «Il Palazzo dei Destini Incrociati», bot. Mondadori, Milano, 2016
- Giusti, M. A., "Albania, architettura e città 1925-1943", Florence, Maschietto Editore, 2006
- Kadare, I., "Pallati i Ëndrrave», bot. Onufri, Tiranë, 2011
- Kadare, I., "Dimri i Vetmisë së madhe", bot. Onufri, Tiranë, 2011
- Norberg - Schulz, Ch., "L'Abitare. L'insediamento, lo spazio urbano, la casa", Electa, Milano, 1984
- Samonà, G., "La casa popolare degli anni '30", bot. Mario Manieri, Elia, Padova, Marsilio Editori, 1972
- Norberg- Schulz, Ch., L'Abitare. "L'insediamento, lo spazio urbano, la casa", Electa, Milano, 1984

Andi REMBECI

*Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, UT
Departamenti i Historisë*

Sokol ÇUNGA

Arkivi Qendror Shtetëror

TRASHËGIMIA KULTURORE LIBRORE MESJETARE - KODIKËT

Studimi dhe promovimi i tyre dhe sot

Abstract

In the Central State Archive of Tirana, Albania, there is a collection of approximately 100 Byzantine and post Byzantine manuscripts, arranged in the Fund "Codices of Albania", bearing the index number 488. On the ground of palaeographical or philological studies, few things have been said about this collection. In the present paper we will try to bring forth all the historical data relating the CSA's manuscripts collection, the most important publications and exhibitions of this collection. We will evaluate the earlier attempts of cataloguing these manuscripts from different authors, whose endeavors date since the 19th century, and while contextualizing them to the circumstances and

specific conditions of their time, we will evaluate the methodology used in compiling them and how they respond to the nowadays needs of researches. In the end we will take in consideration the existing difficulties which researchers encounter while trying to address to the Tirana collection of manuscripts. Altogether we will mention those endeavors made on encouraging the wide public and students to approach this tangible heritage through different directions and means.

Keywords: *byzantium, byzantine manuscripts, post-byzantine manuscripts, medieval history, methodology, catalography, paleographical studies*

Edhe pse për më shumë se 140 vjet koleksioni i kodikëve bizantinë dhe pasbizantinë të Shqipërisë ka tërhequr vëmendjen e studiuesve¹, ai ka mbetur për arsye të ndryshme, një nga më pak të njohurit në Ballkan, ndërkohë që është një nga më tërheqësit.

Fondi 488 me emërtimin “Kodikët e Shqipërisë” në Arkivin Qendror Shtetëror (AQSh) mori formën e sotshmenëfund të viteve ’70, kohëkur u sistemua fondi

¹ Mbi studimet e koleksionit të kodikëve bizantinë dhe pasbizantinë të AQSh-së, shih Rembeci A., Çunga S., “The Researches on the Byzantine and Post-Byzantine Paleography in Albania, assessments about past and present, perspectives and future challenges”, In Andi Rembeci (ed.), *Methodology and scientific research: Tradition and innovation*, Proceedings of 1st Conference of Albanian Young Academy of the Academy of Sciences of Albania (Tirana, December 4th 2017). Tirana: Albanian Young Academy, Academy of Sciences of Albania, 2019: 67-95, ku paraqitet edhe bibliografia përkatëse.

në fjalë. Ai përmban të gjitha dorëshkrimet bizantine dhe pasbizantine që u sollën nga raftet e bibliotekave të manastireve, mitropolive apo bibliotekave personale në AQSh². Sot Fondi 488 numërton 119 njësi dokumentesh, të cilat kronologjikisht datojnë nga shek. VI - XIX. Sigurisht, dorëshkrimet që u kopjuan apo

2 Mbi procesin e grumbullimit të materialeve me rëndësi historike në AQSh, shih F. 507, V. 1967, D. 5, fl. 1-10: "Qarkore e Këshillit të Ministrave mbi bllokimin e materialeve dokumentare në institucionet fetare si dhe relacione dërguar Komitetit Qendror të Partisë të Punës së Shqipërisë dhe Kryeministrit, mbi rezultatet e arritura në grumbullimin dhe inventarizimin e materialeve dokumentare të Klerit në Shkodër dhe Korçë"; F. 507, V. 1967, D. 41, fl. 1-6: "Relacion mbi grumbullimin, sistemimin dhe inventarizimin e materialeve dokumentare dhe fondit bibliotekar të klerit katolik, mysliman dhe ortodoks në rrethet Shkodër, Durrës, Krujë dhe qytetin e Tiranës" dhe F. 507, V. 1967, D. fl. 1-28: "Plan masash për grumbullimin e dokumenteve të institucioneve fetare në rrethe dhe relacione mbi gjendjen, grumbullimin, sistemimin dhe inventarizimin e dokumenteve të institucioneve fetare", sikundër paraqiten te Andi Rembeci, "Gli archivi ecclesiastici presso l'Archivio Statale Centrale di Tirana come testimonianza di fonti storiche e culturali. Verso un dialogo culturale aperto". In Gaetano Zito (ed.), *III Conferenza degli Archivisti Ecclesiastici Europei "Archivi della Chiesa e Archivi dello Stato: luogo di dialogo culturale"*, Poznań, 7-9 novembre 2018. Città del Vaticano, 2019: 41-56, ku paraqiten edhe bibliografia përkatëse. Shih gjithashtu, Fondi DPA, D. 8, V. 1967, f. 14, Urdhër pagese. Për më tepër, shih transkriptimin e procesverbalit mbajtur mes Theofan Popës, dorëzues, dhe Mediha Shuteriqi, marrëse në dorëzim në: Shaban Sinani, *Kodikët e Shqipërisë në "Kujtesën e Botës"*, (Tiranë: Naimi, 2011): 196-197. Shih edhe Andi Rembeci dhe Sokol Çunga (authors) Agamemnon Tselikas (scientific supervision) Ioannis Vitaliotis (contributor), *The Illuminated Gospel of Korça. Korça Codex 93 (10th century)*, Facsimile edition, 3 vols, 1.272 pp, Athens: Militos Edition, 2012, vol. 1: 25-26. Sokol Çunga, "The Central State Archive of Albania. A short history and its collection of ecclesiastical documents", in Gaetano Zito (ed.) *Seconda Conferenza di Archivisti Ecclesiastici Europei* (Roma-Sassone, 29-30 aprile-1 maggio 2013). Associazione Archivistica Ecclesiastica: Quaderni di "Archiva Ecclesiae" 12, (Città del Vaticano, 2014), 38-39.

që ndodheshin në territorin e Shqipërisë së sotshme gjatë periudhës bizantine apo të mëvonshme ishin padyshim shumë më të tepërt në numër nga sa ruhen sot³. Gjallëria dhe lulëzimi kulturor gjatë shekujve të mëparshëm dëshmohet në mënyrë të pakundërshtueshme nga monumentet e ndryshëm të periudhës paleokristiane, bizantine dhe pasbizantine që ruhen ende sot në Shqipëri – siç janë monumente arkitekturore të dekoruara me afreske mjeshtërore, si dhe kryevepra të punuara në metal, mikroskulptura, qëndistari, gdhendje druri dhe kodikë të dorëshkruar. Qendrat e rëndësishme shpirtërore dhe kulturore, me rol të rëndësishëm edhe në kohën e sotshme, si Berati, Durrësi, Vlora, Korça, Gjirokastra etj., kishin mbledhur një koleksion të konsiderueshëm kodikësh të dorëshkruar.⁴

Kodikët e Shqipërisë, që datojnë nga shek. VI - XIX përfaqësojnë një hallkë të rëndësishme të rrugëtimit

³ Për dorëshkrime që në të shkuarën kanë qenë pjesë e bibliotekave të qendrave kishtarë në hapësirën shqiptare, shih, ndër të tjera, edhe Άνθιμος Αλεξούδης, «Κατάλογος τῶν ἐν ταῖς ἱεραῖς ἐκκλησίαις τῆς συνοικίας Κάστρου, πόλεως Βερατίου τῆς Μητροπόλεως Βελεγράδων εὗρισκομένων ἀρχαίων χειρογράφων», *Δελτίον της Ιστορικής και Εθνολογικής Εταιρίας της Ελλάδος* 5 (1900): 352-369; Pierre Batiffol, «Les manuscrits grecs de Bérat d'Al-banie et le Codex Purpureus Φ», *Archives des missions scientifiques et littéraires*, 3e série, Paris, 13 (1887), appendix 2, 437-556; Νίκος Βέης, «Κατάλογος τῶν χειρογράφων κωδίκων τῆς ἀγιωτάτης Μητροπόλεως Ἀργυροκάστρου», *Επετηρίς του Μεσαιωνικού Αρχείου* 4 (1951): 129-209.

⁴ Shih *Répertoire des bibliothèques et des catalogues de manuscrits grecs de Marcel Richard*, Troisième édition entière mentre fondue par Jean-Marie Olivier, Brepols-Turnhout 1995.

të gjatë kulturor mbi 1400-vjeçar të artit të librit të dorëshkruar mesjetarë, të historisë dhe të traditës së krishterë, duke konfirmuar rolin e pazëvendësueshëm të bibliotekave në evolucionin e civilizimit.

Duke mbledhur dëshmitë e reflektimeve filozofike, fetare, shkencore dhe artistike, librat mesjetarë kanë marrë në fakt identitetin e “depove” të vërteta të kujtesës, e mjeteve për ruajtjen por edhe për studimin, hulumtimin, përditësimin ose thjesht kënaqësinë estetike të atyre dorëshkrimeve, teksteve të dekoruara me miniaturë të mrekullueshme, që historia e kulturës ka prodhuar dhe vendosur gjatë shekujve.

Pjesë e rëndësishme e këtij koleksioni janë edhe dy kodikët e purpurt perandorakë bizantinë, Beratinus 1 dhe Beratinus 2⁵, pjesë e një koleksioni të

⁵ Për kodikët Beratinus 1 dhe Beratinus 2, shih përgjithësisht punimet e: Pierre Batiffol, «Les manuscrits grecs de Bérat d’Albanie et le Codex Purpureus Φ», *Archives des missions scientifiques et littéraires*, 3e série, Paris, 13 (1887), appendix 2, 437-556. Theofan Popa, “Katalog i kodikëve kishtarë mesjetarë të Shqipërisë”, në: *Kodikët e Shqipërisë*, (ed. Shaban Sinani et al.), (Tiranë: AQSh, 2003), 87-198. Andi Rembeci dhe Sokol Çunga, *Dorëshkrime Bizantine dhe Pashizantine në Shqipëri, Katalog shkencor*, (Tiranë: Fondacioni Grek i Kulturës-Vatra Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 2010); Shaban Sinani, *Kodikët e Shqipërisë në “Kujtesën e Botës”*, (Tiranë: Naimi, 2011); Axinia Džurova, *Manuscrits grecs enluminés des Archives Nationales de Tirana (VIe-XIVe siècle)*, Études Choiesies, 2 vols, (Sofia: Centre de Recherches Slavo-Byzantines “Ivan Dujčev”, Université de Sofia “St. Clément d’Ohrid”, 2011); Axinia Džurova and Paul Canard, *Le rayonnement de Byzance, les manuscrits grecs enluminés des Balkans VIe-XVIIIe siècles. Catalogue d’exposition. XXIIe Congrès Internationales d’Etudes Byzantines*, Sofia, 22-27 août 2011. (Sofia: Galerie Nationale d’Art

mrekullueshëm librash luksozë, prodhimi i të cilëve arriti kulmin me Justinianin e Madh.

Kodiku i Purpurt i Beratit nr. 1 (Beratinus I), emërtuar ndryshe Beratinus Purpureus, përfaqëson një nga dorëshkrimet më të vjetra në të gjithë botën me tekstet e Ungjijve, dhe është krijuar në shek. VI. Tekstet janë shkruar me bojë argjendi në pergamenë të ngjyrosur në të purpurt, ndërsa për emrat e shenjtë është përdorur ari. Kodiku Beratinus 1, i është një ndër pesë ekzemplarët e shkëlqyer që trashëgon bota sot nga shek. VI. Vlerat e tij unike rrjedhin jo vetëm nga vjetërsia, por edhe nga forma. Format monumentale, madhështia e paraqitjeve grafike, përdorimi i pergamenës me ngjyrë të purpurt dhe i bojërave të çmuara e bëjnë këtë vepër arti – ashtu sikundër edhe katër kodikët e tjerë të purpurt bashkëkohës, si kodiku i Rossanensis i Muzeut Kryepeshkopal të Rossano të Kalabrisë me zbukurime mbititullore të arta, tekst të shkruar në argjend dhe miniatura të mrekullueshme;

étranger, 2011), 29-38, 88-89, 91-92, 124-125, 126-127, 146, 160, 191; Joan Lena, "The Byzantine Manuscripts in the Central State Archive of Albania (Tirana)", në *Catalogue of Byzantine Manuscripts in their liturgical context*, edited by Klaas Spronk et al. 1-Challenges and perspectives (Belgium: 2013): 215-234; Didier Lafleur and Luc Brogly, "Numbering Concordance of the Greek Manuscripts from Albania", in *Greek New Testament manuscripts from Albania*, (Leiden; Boston: Brill, cop. 2018), 523-547, Appendix A. Për kodikun Beratinus 1 shih tezën e doktoratës së z. Vilson Marku, pranë Universitetit Karl-Franz të Gracit (Vestigia - The Manuscript Research Centre of Graz University): De Marku, Vilson, *Kodex Purpureus Beratinus Φ 043. Geschichte – Textkritik – Edition Eine neue Bestandsaufnahme*. 2019.

kodiku Sinopensis i Bibliotekës Kombëtare të Parisit, i shkruar me germa të arta; kodiku Petropolitanus me germa të argjendta; kodiku Genesis i Vjenës, i Bibliotekës Kombëtare të Austrisë, i shkruar me germa të argjendta dhe i zbukuruar me miniatura – një produkt libror i konceptuar më së shumti për lartësimin simbolik dhe pamor të tekstit të shenjtë dhe të vlerave të lidhura me të.

Kodiku i purpurt i Beratit nr. 2 (Beratinus II), i emëruar ndryshe si Codex Aureus Anthimi daton në shek. IX dhe është produkt i punishteve të begata libërshkruese të Kostandinopojës gjatë një periudhe ku realizohen lëvizje të fuqishme intelektuale dhe artistike në Bizant dhe që u njohën në histori si Rilindja Maqedonase. Kodiku Beratinus 2 përbëhet nga 420 fletë pergamene të purpurt, i tërë teksti i katër ungjijve është shkruar në ar dhe po në ar janë realizuar edhe miniaturat e ungjillorve, zbukurimet mbititullore dhe germat nistore. Pavarësisht studimeve gjithëpërfshirëse mbi dekorimet dhe ilustrimet e kodikëve bizantinë, shfaqja e çfarëdo dorëshkrimi që i përket Rilindjes Maqedonase dhe, për më tepër, nga punishte kodikëshkruese konstandinopolitane, nuk dështon së tërhequri interesin e specialistëve dhe të publikut të gjerë, siç është edhe rasti i Kodikut të Purpurt të Beratit nr. 2 (Beratinus II).

Përpjekja e parë studimore për t'i bërë të njohur kodikët e Shqipërisë jashtë hapësirës shqiptare u

bë prej dijetarit dhe mitropolitit të Beratit, Anthim Aleksudhit, i cili më 1868 botoi, në librin e tij *Përshkrim i shkurtër historik i Mitropolisë së Hirëshme të Beratit...*, përshkrime të shkurtra të katër prej dorëshkrimeve më të veçantë, të cilët ishin pjesë e bibliotekës së Mitropolisë⁶. Aty përfshihen edhe tre dorëshkrime në pergamenë të purpurt, nga të cilët dy janë kodikët e sotshëm *Beratinus 1* dhe *Beratinus 2*, kurse të tretin e konsiderojmë të humbur. Përpjekjen e tij për të regjistruar dhe botuar informacione për kodikët e Shqipërisë, nxitën kuriozitetin e studiuesve perëndimorë. Kështu, në vitet '80 të shek. XIX, studiuesi belg Pierre Batiffol vizitoi Mitropolinë e Beratit për të hulumtuar bibliotekën dhe arkivin, si dhe për t'u njohur nga afër me pasuritë dorëshkrimore të saj. Përfundimet e kërkimeve të tij Batiffol-i i botoi më 1886 në një artikull ku përshkruante 16 kodikë, si dhe tekstin e transkriptuar të kodikut të purpurt *Beratinus 1*⁷. Nëse Batiffol-it i njihet merita e sjelljes së tekstit të kodikut *Beratinus 1* në dorën e studiuesve perëndimorë dhe kryesisht atyre frankofonë. Pa asnjë kundërshtim Anthim Aleksudhit ka meritën për prezantimin botërisht të një kodiku që deri asokohe ishte i panjohur.

⁶ Άνθιμος Ἀλεξούδης, *Σύντομος Ἱστορική Περιγραφή τῆς Ἱερᾶς Μητροπόλεως Βελεγράδων καὶ τῆς ὑπὸ τὴν Πνευ-ματικὴν Αὐτῆς Δικαιοδοσίαν Ὑπαγομένης Χώρας*, Κέρκυρα, 186, fq.113-115.

⁷ Batiffol, "Les manuscrits grecs", 554-556.

Në fillim të viteve '50 të shek. XX, kodikët e dorëshkruar që u mbajtën të padëmtuar dhe u ruajtën si drita e syrit nëpër shekuj, do të përballen me luftën graduale kundra religjionit në Shqipëri, deri në daljen hapur kundër tyre më 1967. Paralelisht me shkatërrimin e qindra kishave dhe manastireve, u shkatërrua një numër i rëndësishëm librash të dorëshkruar, fetarë ose jo, ndërsa një pjesë e tyre filluan të silleshin në AQSh, proces ky që vazhdoi deri në fund të viteve '80⁸. Një çast i rëndësishëm në historinë e këtij fondi ishte viti 1968, kur dy dorëshkrimet e purpurt, *Beratinus 1* dhe 2, pasi u zbuluan në një vend i fshehtë në hijeroren e kishës së Fjetjes së Hyjlindëses në lagjen Kala të Beratit, sot Muzeu Onufri, iu bashkuan koleksionit të kodikëve⁹.

Hapja e parë e AQSh për publikun ndërkombëtar ndodhi në vitin 2000, kur një pjesë e *Beratinus 1* u ekspozua në ekspozitën "Gli Evangeli degli popoli", çelur në Vatikan me rastin e festimeve të 2000 vjetorit të Krishterimit¹⁰. Në veçanti, festimet e mijëvjeçarit

⁸ Që në vitet 1955-1957, Instituti i Shkencave të Shqipërisë kishte filluar veprimtarinë për evidentimin dhe tërheqjen e dokumenteve me vlerë historike nga arkivat dhe bibliotekat e kishave dhe të manastireve ortodokse. Shih, më sipër, fundshënimin këtu nr. 2.

⁹ AQSh i RSh, Fondi 14/AP STR, Viti 1971, Dosja 390: Historiku i përgatitur nga punonjësit e arkivave të shtetit, shokëve Reshat Alia e Sanie Mara si dhe një shënim i shokut Kahreman Ylli "Mbi zbulimin e kodikëve të shekujve të 6-të dhe 9-të, në vitin 1968 në Berat dhe restaurimi i tyre në Republikën Popullore të Kinës", fl. 2-4.

¹⁰ Giovanni M., Piazzoni A.M., D' Aiuto F., *I Vangeli dei popoli: la parola*

të ri të epokës së krishterë ofruan mundësinë për të admiruar në nivel ndërkombëtar shembuj unikë të trashëgimisë së librit të dorëshkruar mesjetar, mes të cilëve edhe kodiku i purpurt Beratinus 1, një dorëshkrim i çmuar i shek. VI, që asnjëherë nuk ishte ekspozuar më parë para një publiku ndërkombëtar dhe që prej kohësh konsiderohej i humbur.

Në vitin 2003, nën kujdesin e drejtorit të atëherëshëm të DPA-së, Prof. Shaban Sinanit, ndërmerret një nismë për të sjellë tek lexuesi i specializuar dhe ai i thjeshtë, vendas dhe i huaj, çdo të dhënë mbi kodikët që ndodhen në Shqipëri¹¹. Pjesë e kësaj nisme do të konsideronim edhe renditjen zyrtare të dy kodikëve të Fondit 488, *Beratinus 1 & 2*, në Regjistrin e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s më 2005¹².

Në maj të vitit 2008 do të njihen me koleksionin e dorëshkrimeve bizantine, prof. Axiania Džurova,

e l'immagine del Cristo nelle culture e nella storia: [mostra, Città del Vaticano, Palazzo della Cancelleria, 21 giugno - 10 dicembre 2000]. Città del Vaticano: Biblioteca apostolica vaticana, 2000.

¹¹ Sinani, *Kodikët e Shqipërisë*, 2003.

¹² Mbi fillimin e procesit të aplikimit për regjistrimin e dy kodikët e purpurt të Beratit në Regjistrin e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, shih Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, F. 507, V. 2003, D. 157. Për njoftimin e regjistrimit, shih F. 507, V. 2005, D. 154. Për më tepër, shih Koïchiro Matsuura, "Pierre fondatrice à l'édifice de la patrimoine", në Sinani, *Kodikët e Shqipërisë*, 2003, 7, 9. Shaban Sinani, "Codex Beratinus 1 and 2, "memory of the world" Register nomination form", in Sinani, *Kodikët e Shqipërisë në "Kujtesën e Botës"*, 2011, 413-466. Shaban Sinani, "Dy kodikët e purpurt të Beratit në kujtesën e botës", in *Art & Trashëgimi: Trashëgimia Ortodokse e Shqipërisë*, nr. 7, v. 2016, (Tiranë: Shoqata "Argjiro", 2016), 164-166.

Drejtores në atë kohë e Qendrës së Studimeve Slavo-Bizantine “Ivan Dujčev”, në Sofje, së bashku me një grup të ngushtë bashkëpunëtorësh. Fryt i bashkëpunimit të grupit të Sofjes me AQSh, nën drejtimin e znj. Nevila Nika, u kurorëzua me realizimin e dy evenimenteve të rëndësishme promovuese për koleksionin e kodikëve të AQSh: e para konsistonte në botimin në frëngjisht, në vitin 2011, nën serinë *Scriptorium Balcanicum*, e veprës me titull *Manuscripts grecs enluminés des archives nationales de Tirana (VIe-XIVe siècles)*, një studim i mirëfilltë shkencor, në dy vëllime, mbi miniaturat dhe dekoret e kodikëve të AQSh¹³. E dyta, konsistonte në njohjen dhe promovimin e koleksionit të kodikëve të Tiranës përmes paraqitjes së 14 kodikëve (në origjinal) në ekspozitën “Shkëlqimi i Bizantit. Dorëshkrime bizantine të dekoruara në Ballkan”¹⁴, çelur me rastin e Kongresit të 22-të Ndërkombëtar të Studimeve Bizantine në Sofje, Bullgari. Ekspozita u vizitua nga rreth 1800 studiues pjesëmarrës në kongres dhe rreth 9 000 vizitorë.

¹³ Axinia Džurova, *Manuscripts grecs enluminés des Archives Nationales de Tirana (VIe-XIVe siècle)*, Études Choisies, 2 vols, (Sofia: Centre de Recherches Slavo-Byzantines “Ivan Dujčev”, Université de Sofia “St. Clément d’Ohrid”, 2011).

¹⁴ Axinia Džurova dhe Paul Canart, *Le Rayonnement de Byzance. Les manuscrits grecs enluminés des Balkans (VIe-XVIIIe siècle)*, Catalogue d’exposition (XXIIe Congrès Internationales d’Études Byzantines, Sofia 22-27 août 2011), 29-38, 88-89, 91-92, 124-125, 126-127, 146, 160, 191.

Më 2012, me bashkëpunimin e Shoqërisë Ndërkonfesionale Biblike Shqiptare, Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave u ndërmor një përpjekje serioze për promovimin e kodikëve të Shqipërisë në botën perëndimore përmes botimeve faksimile. Kështu, u botua botimi faksimile i *Kodiku të Korçës nr. 93*, një dorëshkrim i përveçëm i shek. X, i përgatitur nga prezantuesi i kësaj kumtese së bashku me z. Sokol Çunga dhe nën udhëheqjen shkencore të prof. Agamemnon Celikas, një autoritet botëror i paleografisë¹⁵. Një botim faksimile i këtij lloji është i pari në historinë e botimeve dokumentare në Shqipëri në tri gjuhë për të mundësuar sa më shumë promovimin e tij.

Botimi më i ri që lidhet me koleksionin e dorëshkrimeve bizantine dhe pasbizantine të AQSh-së është *"Greek New Testament Manuscripts from Albania"*, me autorë Didier Lafleur dhe Luc Brogly¹⁶.

¹⁵ Andi Rembeci, Sokol Çunga (authors), Agamemnon Tselikas (scientific supervision) Ioannis Vitaliotis (contri-butor), *The Illuminated Gospel of Korça. Korça Codex 93 (10th century)*, Facsimile edition, three volumes, 1.272 pp, Militos Edition, Athens: 2012. Andi Rembeci dhe Sokol Çunga, "Kodiku i Korçës nr. 93. Katërrungjillëshi bizantin i shek. X.", *Kërkim* 10 (2013): 79-93. Për një vlerësim shqyrtues të veprës nga J. K. Elliot, Professor Emeritus i New Testament Textual Criticism në University of Leeds, shih "Bibliography: The Four Gospels of Korça," in: *The Times Literary Supplement*, April 5, 2013: 27.

¹⁶ Didier Lafleur and Luc Brogly, *Greek New Testament manuscripts from Albania*, (Leiden; Boston: Brill, cop. 2018).

Monografia, siç thonë vetë autorët, ka qëllim të eksplorojë pasuritë e një koleksioni unik prej njëzet e një artefaktesh bizantine, midis të cilëve kodikët me famë botërore Beratinus 1 dhe Beratinus 2, të dyja të përfshira nga UNESCO në Regjistrin e Kujtesës së Botës.

Së fundmi, në vitin 2018 autori i këtij artikulli së bashku me z. Sokol Çunga, nën cilësinë e të ftuarve prej Comité International de Paléographie Grecque (CIPG) me qendër në Paris, prezantuan në një sesion të posaçëm të IX e Colloque International de Paléographie Grecque “Le livre manuscrit grec : écritures, matériaux, histoire” (Le lívre mánuskrit grek: ékriytyr, materió, histuar), mbajtur në Sorbonne Université dhe École Normale Supérieure, temën me titull “Greek Manuscripts in Albania: Book Circulations and Libraries”, ku bënë një paraqitje të hollësishme të dorëshkrimeve bizantine dhe pasbizantine që ndodhen në Shqipëri.

Shqipëria është vend i panjohur dhe ekzotik jo vetëm për turistët, por, çuditërisht, edhe 25 vite pas hapjes së saj për botën, vend i panjohur edhe për studiuesit. Kjo duket nga numri i vogël i studiuesve ndërkombëtarë në arkivat vendore, te përqendrimi i interesit të studiuesve tek e shkuara e afërt komuniste, apo periudha e ndryshimeve politiko-ekonomike.

Sigurisht, pyetja e vetvetishme, teksa mendojmë për promovimin e tyre në të ardhmen, shtrihet

në dy plane: e para cila është situata e studentëve universitarë të sotshëm, të cilët nesër do të bëhen përçuesit dhe promovuesit e vlerave të kësaj trashëgimie të çmuar kulturore? Dhe e dyta cilat janë përpjekjet e institucioneve publike që lidhen me kulturën për promovimin e kësaj gjinie të përveçme me vlera botërore.

Pas viteve '90, gjuhët e vdekura apo ato të rralla, si greqishtja, latinishtja, osmanishtja, që mësoheshin tradicionalisht në shkollat e Shqipërisë, humbën popullaritetin mes studentëve. Kjo solli, si pasojë, pothuaj zhdukjen e tyre nga kurrikulat universitare, si dhe formimin e historianëve, të arkeologëve dhe të studiuesve të rinj të trashëgimisë kulturore me njohuri të paplota gjuhësore. Sigurisht, realiteti nuk është krejt pesimist. Në çastin që flasim, në Departamentin e Historisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, prej 10 vitesh është çelur, si lëndë me zgjedhje, Paleografia Bizantine¹⁷. Sigurisht, për shkak të mungesës së formimit gjuhësor, studentët fokusohen më shumë te historia e librit të dorëshkruar mesjetar dhe kodikologjia, pa u marrë drejtpërdrejt me shkrimin. Këtë vakum

¹⁷ "Plani mësimor i diplomës Bachelor Histori, sistemi me kohë të plotë", Departamenti i Historisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universitetit të Tiranës, konsultuar në dhjetor 2018, <https://www.fhf.edu.al/plani-mesimor-histori/>

përpiqet ta mbushë lënda e greqishtes bizantine¹⁸, e cila funksionon që prej 7 vitesh, përsëri, si lëndë me zgjedhje në të njëjtin departament. Paralelisht, prej 5 vitesh, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës, organizon shkollën verore mbi “Gjuhën, historinë dhe civilizimin bizantin”¹⁹, nën drejtimin e bizantologut dhe paleografit, z. Andi Rembeci, pedagog i këtij Departamentit të Historisë. Shkolla verore lidhen drejtpërsëdrejti me lëvrimin dhe studimin e gjuhës dhe të historisë së librave dhe dokumenteve mesjetare. Qëllimi fundor i këtyre lëndëve është njohja e studentëve të historisë, të

¹⁸ “Plani mësimor i diplomës Bachelor Histori, sistemi me kohë të plotë”, Departamenti i Historisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universitetit të Tiranës, konsultuar në dhjetor 2018, <https://www.fhf.edu.al/plani-mesimor-histori/>

¹⁹ Shkolla verore zhvillohet nën përkujdesjen shkencore të *departamentit të historisë me koordinatör përgjegjës z. Andi Rembeci* dhe të *profesor Agamemnon Tselikas*, një autoritet botëror i pleografisë dhe Drejtor i Historical and Palaeographical Archive of the National Bank of Greece Cultural Foundation (MIET), Greqi. Stafi mësimor përbëhet nga profesorë dhe studiues të shquar nga institucione prestigjioze të studimeve bizantine të Greqisë, nga departamenti i historisë i Universitetit të Tiranës si dhe bashkëpunëtorë të jashtëm të tij, me përvojë të gjerë në fusha që lidhen me gjuhën greke, historinë dhe civilizimin bizantin dhe pasbizantin. Për më tepër shih:

“Shkolla e parë Verore e Gjuhës, Historisë dhe Civilizimit Bizantin” (13-21 korrik 2017), Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universitetit të Tiranës, konsultuar në dhjetor 2018, <https://www.fhf.edu.al/shkolla-e-pare-verore-e-gjuhes-historise-dhe-civilizimit-bizantin/>.

“9-17 korrik 2018. Shkolla verore e Gjuhës, Historisë dhe Civilizimit Bizantin”, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universitetit të Tiranës, konsultuar në dhjetor 2018, <https://www.fhf.edu.al/9-17-korrik-2018-shkolla-verore-e-gjuhes-historise-dhe-civilizimit-bizantin/>

arkeologjisë dhe të trashëgimisë kulturore jo vetëm me greqishten bizantine, por edhe me gjuhën e librit dhe të dokumentit mesjetar gjatë periudhës bizantine dhe pas-bizantine. Po ashtu, janë vendosur bashkëpunime mes Departamentit të Historisë me Departamentin e Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, por edhe me departamente të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja me qëllim njohjen e studentëve që profilizohen në promovimin e trashëgimisë sonë kulturore me këtë pasuri librare.

Mungesa e një platforme të mirëmenduar për ekspozimin, qoftë edhe periodik, të dy kodikëve të purpurt të Beratit, tashmë pjesë e programit të vlerave më elitare të pasurive shpirtërore të njerëzimit “Memoire du Monde” (Memory of World, Kujtesa e Botës) e UNESCO-s, në mjediset e AQSh-së dhe mungesa e një vendi ekspozimi ka shkaktuar mosparaqitjen e kodikëve të Shqipërisë në të gjitha platformat kombëtare dhe ndërkombëtare të promovimit të turizmit kulturor. Po ashtu, mungesa paralele e një website dedikuar kodikëve të Shqipërisë dhe, më konkretisht kodikëve të purpurt të Beratit, sikundër gëzojnë katër kodikët e tjerë simotra të shek. VI: Rossanensis i Muzeut Kryepeshkopal të Rossano të Kalabrisë; kodiku Sinopensis i Bibliotekës Kombëtare të Parisit; kodiku Petropolitanus; kodiku Genesis i Vjenës, i Bibliotekës Kombëtare të Austrisë, kanë penguar qasjen e të interesuarve, qofshin këta

studiues apo publik i gjerë, jashtë apo brenda vendit, në materialin informativ dhe vizual të kodikëve të lartpërmendur.

BIBLIOGRAFI

- AQSh i RSh, Fondi 14/AP STR, Viti 1971, Dosja 390: Historiku i përgatitur nga punonjësit e arkivave të shtetit, shokëve Reshat Alia e Sanie Mara si dhe një shënim i shokut Kahreman Ylli "Mbi zbulimin e kodikëve të shekujve të 6-të dhe 9-të, në vitin 1968 në Berat dhe restaurimi i tyre në Republikën Popullore të Kinës", fl. 2-4.
- AQSh, F. 507, V. 1967, D. 41, fl. 1-6: "Relacion mbi grumbullimin, sistemimin dhe inventarizimin e materialeve dokumentare dhe fondit bibliotekar të klerit katolik, mysliman dhe ortodoks në rrethet Shkodër, Durrës, Krujë dhe qytetin e Tiranës".
- AQSh, F. 507, V. 1967, D. 5, fl. 1-10: "Qarkore e Këshillit të Ministrave mbi bllokimin e materialeve dokumentare në institucionet fetare si dhe relacione dërguar Komitetit Qendror të Partisë të Punës së Shqipërisë dhe Kryeministrisë, mbi rezultatet e arritura në grumbullimin dhe inventarizimin e materialeve dokumentare të Klerit në Shkodër dhe Korçë"
- AQSh, F. 507, V. 1967, D. fl. 1-28: "Plan masash për grumbullimin e dokumenteve të institucioneve fetare

në rrethe dhe relacione mbi gjendjen, grumbullimin, sistemimin dhe inventarizimin e dokumenteve të institucioneve fetare”.

AQSh, F. 507, V. 2003, D. 157.

AQSh, F. 507, V. 2005, D. 154.

AQSh, F. DPA, D. 8, V. 1967, f. 14, Urdhër pagese.

Andi Rembeci, Sokol Çunga, “Kodiku i Korçës nr. 93. Katërungjillëshi bizantin i shek. X.”, *Kërkim* 10 (2013): 79-93.

Andi Rembeci, Sokol Çunga, *Dorëshkrime Bizantine dhe Pashbizantine në Shqipëri, Katalog shkencor*, (Tiranë: Fondacioni Grek i Kulturës-Vatra Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 2010). Axinia Džurova, *Manuscripts grecs enluminés des Archives Nationales de Tirana (VIe-XIVe siècle)*, Études Choiesies, 2 vols, (Sofia: Centre de Recherches Slavo-Byzantines “Ivan Dujčev”, Université de Sofia “St. Clément d’Ohrid”, 2011).

Andi Rembeci, “Gli archivi ecclesiastici presso l’Archivio Statale Centrale di Tirana come testimonianza di fonti storiche e culturali. Verso un dialogo culturale aperto”. In Gaetano Zito (ed.), *III Conferenza degli Archivisti Ecclesiastici Europei “Archivi della Chiesa e Archivi dello Stato: luogo di dialogo cul-turale”*, Poznań, 7-9 novembre 2018. Citta del Vaticano, 2019: 41-56.

Andi Rembeci, Sokol Çunga (authors) Agamemnon Tselikas (scientific supervision) Ioannis Vitaliotis (contributor), *The Illuminated Gospel of Korça. Korça Codex 93 (10th century)*, Facsimile edition, 3 vols, 1.272 pp, Athens: Militos Edition, 2012.

Andi Rembeci, Sokol Çunga “The Researches on the

- Byzantine and Post-Byzantine Paleography in Albania, assessments about past and present, perspectives and future challenges”, In Andi Rembeci (ed.), *Methodology and scientific research: Tradition and innovation*, Proceedings of 1st Conference of Albanian Young Academy of the Academy of Sciences of Albania (Tirana, December 4th 2017). Tirana: Albanian Young Academy, Academy of Sciences of Albania, 2019: 67-95.
- Axinia Džurova, Paul Canard, *Le rayonnement de Byzance, les manuscrits grecs enluminés des Balkans VIe-XVIIIe siècles. Catalogue d'exposition. XXIIe Congrès Internationales d'Etudes Byzantines*, Sofia, 22-27 août 2011. Sofia: Galerie Nationale d'Art étranger, 2011.
- Axinia Džurova, *Manuscrits grecs enluminés des Archives Nationales de Tirana (VIe-XIVe siècle)*, Études Choiesies, 2 vols, (Sofia: Centre de Recherches Slavo-Byzantines “Ivan Dujčev”, Université de Sofia “St. Clément d’Ohrid”, 2011).
- Didier Lafleur, Luc Brogly, “Numbering Concordance of the Greek Manuscripts from Albania”, in *Greek New Testament manuscripts from Albania*. (Leiden; Boston: Brill, cop. 2018), 523-547, Appendix A.
- Didier Lafleur, Luc Brogly, *Greek New Testament manuscripts from Albania*, (Leiden; Boston: Brill, cop. 2018).
- Giovanni M., Piazzoni A.M., D’Aiuto F., *I Vangeli dei popoli: la parola e l’immagine del Cristo nelle culture e nella storia: [mostra, Città del Vaticano, Palazzo della Cancelleria, 21 giugno - 10 dicembre 2000]*. Città del Vaticano: Biblioteca apostolica vaticana, 2000.

- J. K. Elliot, "Bibliography : The Four Gospels of Korça," in: *The Times Literary Supplement*, April 5, 2013: 27.
- Joan Lena, "The Byzantine Manuscripts in the Central State Archive of Albania (Tirana)", në *Catalogue of Byzantine Manuscripts in their liturgical context*, edited by Klaas Spronk et al. 1-Challenges and perspectives (Belgium: 2013): 215-234.
- Koïchiro Matsuura, "Pierre fondatrice à l'édifice de la patrimoine", në Sinani, *Kodikët e Shqipërisë*, 2003.
- Pierre Batiffol, «Les manuscrits grecs de Bérat d'Albanie et le Codex Purpureus Φ», *Archives des missions scientifiques et littéraires*, 3e série, Paris, 13 (1887), appendix 2, 437-556.
- Répertoire des bibliothèques et des catalogues de manuscrits grecs de Marcel Richard*, Troisième édition entière ment fondue par Jean-Marie Olivier, Brepols-Turnhout 1995.
- Shaban Sinani, "Codex Beratinus 1 and 2, "memory of the world" Register nomination form", in Sinani, *Kodikët e Shqipërisë në "Kujtesën e Botës"*, 2011, 413-466.
- Shaban Sinani, "Dy kodikët e purpurt të Beratit në kujtesën e botës", in *Art & Trashëgimi: Trashëgimia Ortodokse e Shqipërisë*, nr. 7, v. 2016, (Tiranë: Shoqata "Argjiro", 2016), 164-166.
- Shaban Sinani, *Kodikët e Shqipërisë në "Kujtesën e Botës"*. (Tiranë: Naimi, 2011): 196-197.
- Sokol Çunga, "The Central State Archive of Albania. A short history and its collection of ecclesiastical documents", in Gaetano Zito (ed.) *Seconda Conferenza di Archivistici Ecclesiastici Europei* (Roma-Sassone, 29-30 aprile-1 maggio 2013). Associazione Archivistica

Ecclesiastica: Quaderni di "Archiva Ecclesiae" 12, (Citta del Vaticano, 2014), 38-39.

Theofan Popa, "Katalog i kodikëve kishtarë mesjetarë të Shqipërisë", në: *Kodikët e Shqipërisë*, (ed. Shaban Sinani et al.), (Tiranë: AQSh, 2003), 87-198.

Ἀνθιμος Ἀλεξούδης, «Κατάλογος τῶν ἐν ταῖς ἱεραῖς ἐκκλησίαις τῆς συνοικίας Κάστρου, πόλεως Βερατίου τῆς Μητροπόλεως Βελεγράδων εὕρισκομένων ἀρχαίων χειρογράφων», *Δελτίον της Ιστορικής και Ε-θνολογικής Εταιρίας της Ελλάδος* 5 (1900): 352-369.

Ἀνθιμος Ἀλεξούδης, *Σύντομος Ἱστορικὴ Περιγραφή τῆς Γερᾶς Μητροπόλεως Βελεγράδων καὶ τῆς ὑπὸ τὴν Πνευ-ματικὴν Αὐτῆς Δικαιοδοσίαν Ὑπαγομένης Χώρας*, Κέρκυρα, 186.

Νίκος Βέης, «Κατάλογος τῶν χειρογράφων κωδίκων τῆς ἀγιωτάτης Μητροπόλεως Ἀργυροκάστρου», *Επετηρίς του Μεσαιωνικού Αρχείου* 4 (1951): 129-209.

CIP KATALOGIMI NË BK